

Microsoft Access 97/2000 per Windows

Kenan Kurda
2002

kenankurda@gmail.com



Microsoft Access 97/2000 per Windows

1.	Hyrje.....	5
1.1.	Cka eshte baza e shenimeve ?.....	3
1.2.	Funkcionimi.....	3
1.3.	Access Database perdore objekte.....	3
1.4.	Automatizimi i detyrave rutinore	4
2.	Relationel databases ose file.....	5
3.	Karakteristikat e tabelave relacionale	6
4.	RELACIONET DHE QELESAT	8
5.	INTEGRITETI I SHENIMEVE (Informatave).....	
6.	MANIPULIMI I SHENIMEVE RELACIONALE.....	10



Microsoft Access 97/2000 per Windows

1. PARAFJALE

1.1. Cka eshte database(baza e shenimeve) ?

Nje database eshte permbledhje e shenimeve qe :

- Eshte organizuar per nje arsye dhe qellim te caktuar.
- Krijimi , Kontrollimi dhe manipulimi i nje database arrihet permes relation database management system sikurse eshte Access-i. (RDBMS)

1.2. Funkcionimi

Access eshet aktiv ne mbrendesine e Windows-it , cka do te thote se te gjitha teknikat e Windows-it munde ti perdorim , si p.sh. “draging”, “OLE”, “shkeput dhe kopjo” , ...

1.3. Access Databases perdorin objekte

1.3.1. Tabelat

Tabelat permbajne nje teresi te shenimeve qe i perkasin nje qellimi , shembull :

- ☞ Lista e punetoreve te nje firme
- ☞ Produktet per shitje
- ☞ Furnitoret e firmes
- ☞ CD-te apo kasetat e juaja personale

1.3.2. Query

Ky permbane nje sistem i cili na mundesone ne njeren ane te bejme kerkesa te ndryshme ne tabele dhe ne anen tjeter na mundesone qe shenimet ti pershtasim nevojave tona.

shembull :

- Cilet punetore jetojne ne Prishtine ?
- Cilat CD te Adelines i posedoje ?
- Cili eshte artikulli me i shtrenjte ne asortimentin tone ?
- Dua ce cmimet e artikujve sportiv t'i nivelizoj per 1,3 % (me lire/shtrenjte).

1.3.3. Formularet

Formularet jane nje ure mes shfrytezuesit(jush) dhe tabelave.

Ato perdoren qe shenimet ne/nga DB ti konsultojme , ndryshojme ose ti plotesojme me shenime te reja. Ne mundemi direkt ne vete tabele te punojme , mirepo formularet na ndihmojne ce me lehte dhe ne menyre me te pasqyruar mbrenda nje ose disa tabelave te punojme .

1.3.4. Raportet

Raportet kujdesen per verzionin e shtypur te informatave nga baza e shenimeve , dhe ate ne leter apo ne ekran te kompjuterit tone. Keshtu prezentimi dhe kontrollimi i informatave behet ne menyre mjaft atraktive.



Microsoft Access 97/2000 per Windows

1.4. Automatisimi i detyrave rutinore

1.4.1. Macro-t

Mbajtja e kontrollit si dhe starti i nje aplikacioni te caktuar (i ashtuquajtur autoexec macro).

1.4.2. Modulet

Keto bejne perdorimin e Access Basic ose VBA (Visual Basic for Applications).

Modulet nuk do te shqyrtohen ne kete pjese te Access kursit sepse ato kerkojne nga lexuesi te kete nje baze relativisht te mire ne nje gjuhe programuese si dhe njohjen e principeve te OOP (Object Oriented Programing) .



Microsoft Access 97/2000 per Windows

2. RELATIONAL DATABASE

Relational database është një permblendhje e tabelave relacionale (nderlidhore), me fjale të tjera : database permban një grup tabelash e mes këtyre tabelave ekzistojnë relacione (nderlidhje). Dy tabela mundën me qene në relacion si psh. :

■ Një tabelë me informata standarde të punetoreve sikurse vendbanimi dhe datelindja

■ Dhe një tabelë tjetër me pagat e punetoreve të njëjta .

Pra këto dy tabela janë në relacion , sepse aty ekziston një nderlidhje . Që të dy tabelat permbajnë informata për punetoret .

Një tabel (relational table ose tabelë relacionale) permbahet prej :

■ një numri të njohur të kolonave të *emëruara* (vertikalisht si psh. kolonat në excel A,B,C...).

■ një numri të *ndryshueshëm* të rëndeve (horizontalisht si psh. rendel në excel A1,B1,C1...por të paemëruara).

■ Records (rendet , rrokjet) prezantojnë informata relevante për një item (një (ajtem) objekt real) në tabelë.

■ Columns (kolonat) prezantojnë informata për një karakterisike të rëndeve të ndryshme në tabelë.

■ Data (shenim, informate) ose “vlerë” vendoset në intersekcion (perputhshmeri) të rendit me një kolonë.

Shembull :

Tabela me CD private

CD numer	Interpretues	Nr i melodive	Cmimi
1	ABBA	14	720
9	MINATORI	11	540
3	THE BEATLES	20	610

Pra sikurse shifet nga tabela në shembullin e lartë , CD mundet me pasë edhe shumë karakteristika të tjera psh. viti i komponimit , emri i komponuesit , zhanri etj. Me fjale të tjera një tabelë permbanë pasqyrim shumë të thjeshtë në krahasim me realitetin .



Microsoft Access 97/2000 per Windows

3. KARAKTERISTIKAT E TABELAVE RELACIONALE

3.1.1. Cdo interseksion i nje rendi dhe nje kolone eshte i obliguar te permbaje "vlera atomike".

Gabim

:

Vitrina	Sasia
Majte	1 liber , 2 fletore
Mes	3 vizore , 5 libra
Djathte	5 fletore

OK :


Vitrina	Librat	Fletoret	Vizoret
Majte	1	2	0
Mes	5	0	3
Djathte	0	5	0

3.1.2. Vlerat e nje kolone duhet te jene gjithmone te nje lloi .


Ne fjalorin relacionale perdoret termi domein. Nje domein eshte permbledhja e vlerave qe munde ti kete nje kolone.

Shembull :


 paga : vlere numerike


 i martuar : po/jo, me fjale te tjera kjo eshte nje vler logjike

 adresa : tekst

 numri i postes : tekst apo numerik(keshilla ime eshte te perdorni gjitmone domein tekstual).

3.1.3. Cdo rende eshte unik.

 2 rende **nuk guxojne** te jene identike (double records).

 Se paku duhet te ekzistojte **1 kolone** ose nje **permbledhje kolonash** qe perkujdeset qe nje rende si unik te konsiderojme. Kete kolone ose permbledhje kolonash e quajme *qels primare* . Kjo karakteristike perkujdeset qe cdo rendi ti caktohet nje domethenie dhe identifikim.

Numri	Emri	Mbiemri	Nesherbim
122534	Lulzim	Mataj	05/11/1986
122537	Arta	Uka	01/03/1991
237886	Besim	Raci	05/01/1998

3.1.4. Rradhitja e kolonave eshte e pa randesishme.

Struktura e database munde te ndryshohet e njekohesisht relacionet mes tabelave te te mos demetohen .



Microsoft Access 97/2000 per Windows

Shfrytezues te ndryshem te te njejtes database munden pa shume munde te ndryshojne renditjen e kolonave dhe te adaptojne nevojave te tyre. Psh. kolonat qe kane rendesi me te vogel munden te vendosen ne funde te tabelës.

3.1.5. Rradhitja e rendeve eshte e pa rendesishme.

Edhe ketu vlene vrejtja sikurse me larte .

Ne mundemi qe ne funde te tabelës te rexhistrojme shenime te reja e qe ky aktivitet te mos kete kurnjefare ndikimi ne query-it ekzistuese.

3.1.6. Cdo kolone ne kuader te nje tabelë DUHET te kete emer unike .

Pasi qe rradhitja e kolonave eshte e pa rendesishme , cdo kolone i referohemi ne baze te emrit e jo pozites fizike ne tabelë .

Ne kuader te nje database mundet qe emri i nje kolone te perseritet disa here mirepo vetem neper tabelat e ndryshme e **vetem njehere ne te njeten tabelë** .

Shembull : kolona me numer te punetoreve NUMRI perseritet ne shembullin e meposhtem mirepo kjo perseritje eshte ne tabela te ndryshme ne ate te **Punetoreve** dhe ate te **Pagave** .

**Tabela me informata te
punetoreve**

Numri	Emri
912506	Arsimi
125981	Valdeti
126591	Tringa
465123	Arsimi

**Tabela me informata te
pagave**

Numri	Paga
912506	800
125981	850
126591	665
465123	732



Microsoft Access 97/2000 per Windows

4. RELACIONET DHE QELESAT(KEY)

4.1.1. Karakteristikat e nje relacioni

- Relacioni eshte nje asociacion mes 2 ose me shume tabelave
- Relacioni vjene ne shprehje permes vleres se qelsit primare dhe/ose atij sekundare. Ne nje tabele munde te definojme disa qelsa sekundare por vetem nje primare.

4.1.2. Qelesi primare (primary key)

Qelesi primare formohet nga nje ose permledhje kolonash te cilat nje record (rende , rrokje) e identifikojne si unike.

Shembull :

2 punetore munden te kene emrin dhe mbiemrin e njejte dhe ne ate forme jane rexhistruar ne tabele ku elemente tjera nuk disponojme , ne kete raste nga tabela shihet se eshte fjala per nje person te njejte, e ne realitet kemi te bejme me dy persona te ndryshem te cilet rastesisht e kane emrin dhe mbiemrin e njete . Per me e zgjedhe kete problemte kesaj natyre nevoitet qe : ne tabele te rexhistrojme edhe nje element tjeter per te mundur te dallojme keta dy persona te ndryshem. Kjo munde te arrihet psh. me rexhistrimin e elementit te ri ne tabel siq patem rast te shohim ne tabelat me larte **NUMRI**. Ku qdo punetori i caktohen nga nje numer unike dhe ketu shohim menjehere dallimin mes dy record-eve(rendeve). Pra kolona qe paraqet ndryshim behet qels primare (primary-key).

4.1.3. Qelesi sekundare (secondary key)

Qelesi sekundare perbahet prej nje ose grup kolonash qe jane identike me qelesin primare ne nje tabele tjeter, me fjale te tjera qelesi sekundare eshte kopje e qelesit primare ne tabelen tjeter .

Tbl Punetoret

Numri	Emri	Tarifa
912562	Bardhi	T1
912563	Violeta	T2
878999	Jehona	T2

=

Qelesi Primare

=

Qelesi Sekundare

Tbl Tarifas

Tarifa	Ora
T1	10
T2	15
T3	18

=

Qelesi Primare

Qelesat jane **SHUME** te rendesishem , sepse ata i formojne relacionet mes tabelave. Navigimi (Levizja) ne tabele varet nga menyra e definimit te qelsave (korrekte ose jo korrekte). Prej kesaj rrjedhe se qelesi primare ka per detyre dhe **DUHET** qe ne cdo kohe te pengojte dyfishimin e record-eve (rendeve) ne tabele !



Microsoft Access 97/2000 per Windows

5. INTEGRITETI I SHENIMEVE

Integriteti i shenime dmth. Navigimi korrekte ne nje database. Ketu kemi te bejme me dy parime themelore siq vijone :

Entity integrity dhe Referential integrity .

5.1.1. Entity Integrity (Integriteti i Entiteteve)

Entity integrity perbehet nga keto detyrime :

- Vlera e qelesit primare **nuk guxone** kurre te jete “**null**” . Kjo do te thote se Fusha **duhet** te perbeje nje vlere specifike , dhe nuk munde **kurre** te jete e “pa vlere”.
- Rexhistrimi, permirsimi ose asgjesimi(Shlyerja) i te dhenave ne tabela munde “me gene unike” dhe te mos ndikojne ne qelesin primare . ??????????????????

■ Referential Integrity (Integriteti referencial)

Ne rastet kur tabela permbane qeles(a) sekundare vlerat duhet qe :

- ose te jene “null” , pra pa vlere
- ose te jene ne perputhshmeri me vlere ne ndonje tabele tjeter ne kuader te Database.
- vlera e njejte(ne tabelen tjeter) duhet te jete e definuar si qeles primare.



Microsoft Access 97/2000 per Windows

6. MANIPULIMET E SHENIMEVE RELACIONALE

6.1. Unionet

Gjate procesit te unionit tabela e pare(1) dhe tabela e dyte(2) barten se bashku ne tabelen e trete .

Nen kushte qe :

■ Qe te dy tabelat duhet te kene nr e njete te klonave.

■ Dhe se kolonat duhet ta kene nje kuptim.

Shembull :

Tabela 1

Key	Kol 1	Kol 2
1	A	2
2	B	4
3	C	6

+

Tabela 2

Key	Kol 1	Kol 2
1	A	2
4	D	8
5	E	10

=

Unioni

Key	Kol 1	Kol 2
1	A	2
2	B	4
3	C	6
4	D	8
5	E	10

6.2. Diferenca

Tek ndryshimi i dy tabelave gjejme ne tabelen e trete te gjitha rendet qe jane ne tabelen e 1^{re} por JO ne tabelen e 2^{te} . Me tabelat e larteshenuar vijme ne kete rezultatete :

Tabela 1 - Tabela 2

Key	Kol1	Kol2
2	B	4
3	C	6

Tabela 2 - Tabela 1

Key	Kol1	Kol2
4	D	8
5	E	10

6.3. Interseksioni (Intersection)

Interseksioni jepe si rezultate rekordet(rendet) e perbashketa nga tabela 1 dhe tabela 2 :

Key	Kol1	Kol2
1	A	2

6.4. Cartesian Product

Tek produkti i 2 tabelave te gjitha rendet e tabelës se 1^{re} nderlidhen ne secilin rende te tabelës se 2^{te} .

Deri tek ky produkte arrijme ne raste kur definimi i qelseve ne tabela nuk eshte korrekte dhe per kete aresye ky manipulim shpeshehere ekzekutohet ne nivelin e gjuhes se makines dhe perdoret ne ate qaste vetem si hape kalimtare per nje
Kenan Kurda



Microsoft Access 97/2000 per Windows

Union. Pra ne raste kur relacionet mes tabelave nuk jane parashtruar si duhur , ne momentin kur deshirojme qe ato(tabelat) ti konsultojme rezultati eshte gjithemone produkt Cartesian.

T1-Key	T1-Kol1	T1-Kol2	T2-Key	T2-Kol1	T2-Kol2
1	A	2	1	A	2
1	A	2	4	D	8
1	A	2	5	E	10
2	B	4	1	A	2
2	B	4	4	D	8
2	B	4	5	E	10
3	C	6	1	A	2
3	C	6	4	D	8
3	C	6	5	E	10



7. NORMALIZIMI

7.1. Qellimi

Normalizimi është një teknikë që një set (grupe) shenimesh i grupon. Qeellimi është që ky set apo ky grupe të shpërndahet në disa tabela të ndryshme. Këto tabela formojnë fundamentin apo bazën e formimit të Relational Data Base .

Normalizimi arrihet në disa hapa , që quhen hapat e normalizimit. Zbuluesit e kësaj teknike janë zotërinjtë Codd dhe Boyce. Për këto arsye hapat e normalizimit quhen Boyce-Codd normalizimi.

7.2. Një shembull praktike

Të nisemi prej një përmbledhje shenimesh të “Porosinave” të jonormalizuara .

Klienti 1

Luli nga Prishtina , Prishtina shtrihet në sektorin 1.

Porosia : artikulli A (karrika) : 100 cope, artikulli B (tavolina) : 25 cope, artikulli C (vitrine) : 8 cope.

Klienti 2

Agimi nga Gjakova , Gjakova shtrihet në sektorin 2

Porosia : artikulli A (karrike) : 150 cope , artikulli D (vitrina e librave) : 25 cope.

Klienti 3

Rroni nga Prizreni , Prizreni shtrihet në sektorin 2

Porosia : artikulli A (karrike) : 150 cope.

Klienti 4

Valdeti nga Peja , Peja shtrihet në sektorin 3

porosia : artikulli A (karrika) : 100 cope, artikulli D (vitrina e librave) : 10 cope.

Klienti 5

Tringa nga Prishtina , Prishtina shtrihet në sektorin 1

Porosia : artikulli D (Vitrina e librave) : 12 cope.

Mbas kompletimit të përmbledhjes të shenimeve të pa normalizuara, me fjale të tjera kure të gjitha domenët janë të njohura (kur e dijme se cilat shenime do të ruajmë) tek atëherë mund të formojmë një tabelë të pa normalizuar . kjo tabelë nuk përmbanë shenime atomike :

Klienti Nr	Emri	Lokacioni	Spektori	Art-kodi	Art-emri	Sasia
1	Luli	Prishtine	1	A, B, C	karrike,tavolina vitrine	100,25 8
2	Agimi	Gjakove	2	A, D	Karrike, Vitrina e librave	150 25
3	Rroni	Prizren	2	A	Karrike	50
4	Valdeti	Peje	3	A,D	Karrike	100



Microsoft Access 97/2000 per Windows

					Vitrine e librave	10
5	Tringa	Prishtine	1	D	Vitrina e librave	12

7.2.1. Tabela e normalizuar ne hapin 0

7.2.2.

Nje tabele ne hapin 0 e normalizuar permbane vetem vlera atomike dhe i kanoset 'redundanti' :

Klienti nr	Kl. Emri	Lokacion i	Sektori	Art-kodi	Art-Emri	Sasia
1	Luli	Prishtine	1	A	Karrike	100
1	Luli	Prishtine	1	B	Tavoline	25
1	Luli	Prishtine	1	C	Vitrine	8
2	Agimi	Gjakove	2	A	Karrike	150
2	Agimi	Gjakove	2	D	Vitrine e librave	25
3	Rroni	Prizren	2	A	Karrike	50
4	Valdeti	Peje	3	A	Karrike	100
4	Valdeti	Peje	3	D	Vitrine e librave	10
5	Tringa	Prishtine	1	D	Vitrine e librave	12

Eshte e qarte se ne kete tabele gjerat e njejta perseriten disa here, dmth. Kjo tabele **redundant** tregon.

Shembuj te redundant :

- Luli eshte klienti nr 1
- Klienti nr 4 eshte me lokacion nga Peja
- Prishtina shtrihet ne sektorin 1
- Artikulli D eshte vitrine e librave.

Redundant ka keto mungesa dhe pasoja :

- ne raste gabimi permirsimet duhen te behen ne disa vende
- a jeton Valdeti ne Prishtine apo ne Fushe Kosove ?
- do te kemi nevoje per me shume vende ne diske
- Kerkimi i informatave do te jete nje proces i ngadalshem.

Gjate perpunimit (update) te tabelave do te hasim ne probleme :

- nuk do te jeme ne gjendje te rexhistrojme artikujt nese nuk eshte bere porosia
- nuk do te jeme ne gjendje te rexhistrojme klientet nese ata nuk kane bere porosi
- indien we de bestelling van Lemmens schrappen verliezen we de informatie dat Lier in sector 2 ligt.



Microsoft Access 97/2000 per Windows

Per te kaluar prej hapit 0 te normalizimit ne hapin 1 te normalizimit ne duhet te shtojme apo aplikojme nje hape normalizimi.

7.2.3. Hapi i pare i normalizimit

Eliminimi i grupeve perseritese ose plotesishte te mvarura :

- ne zgjedhim nr e klientit si qeles primare (me fjale te tjera ne kerkojme nje qeles unike)
- qeles primare guxon vetem nje here te paraqitet , ku tani per tani ne tabelen tone nuk eshte rasti
- aty jane disa shenime qe jane pergjgjesse per faktin se qeles primare perseritet ; i gjejme ato shenime qe e detyrojne qelesin primere te perseritet dhe te cilat jane te mvarura nga vete qeles primare
- formoje nje table me shenime perseritese + qelesin primare
- eleminoje shenimet perseritese nga relacioni i tabelës

Klienti nr	Kl -Emri	Lokacion i	Sektori	Kodi-Art	Emri-Art	Sasia
1	Luli	Prishtine	1	A	Karrike	100
1	Luli	Prishtine	1	B	tavoline	25
1	Luli	Prishtine	1	C	vitrine	8
2	Agimi	Gjakove	2	A	karrike	150
2	Agimi	Gjakove	2	D	Vitrine e librave	25
3	Rroni	Prizren	2	A	karrike	50
4	Valdeti	Peje	3	A	karrike	100
4	Valdeti	Peje	3	D	Vitrine e librave	10
5	Tringa	Prishtine	1	D	Vitrine e librave	12


Klienti nr	Kl-Emri	Lokacioni	Sektori
1	Luli	Prishtine	1
2	Agimi	Gjakove	2
3	Rroni	Prizren	2
4	Valdeti	Peje	3
5	Tringa	Prishtine	1

PS

Klienti nr	kodi-Art	Emri-Art	Sasia
1	A	karrike	100
1	B	tavoline	25
1	C	vitrine	8
2	A	karrike	150
2	D	Vitrine e libr	25
3	A	karrike	50
4	A	karrike	100
4	D	Vitrine e libr	10
5	D	Vitrine e	12



Microsoft Access 97/2000 per Windows



Mbas hapit te pare te normalizimit tabela jone gjindet ne formen e pare normale. Pasi qe nuke kemi asnje informate plotesishte te mvarur, Tani munde te aplikojme hapin e dyte te normalizimit .

7.2.4. Hapi i 2^{te} i normalizimit

Eleminoje te gjitha fushat plotesishte te mvarura.

- Kerko te dhenat qe jane te mvarura nga nje pjese e qelesit, por jo nga qeles ne teresi. A dhe karrika perseriten shume here dhe A eshte pjese e qelesit, por nuk eshte qeles ne teresi.
- Formo nje tabele me keto te dhena
- Eleminoje shenimet bartura qe nuk bejne pjese ne qeles .

Klinti nr	kodi-Art	Emri-Art	Sasia
1	A	karrike	100
1	B	tavoline	25
1	C	vitrine	8
2	A	karrike	150
2	D	Vitrine e libr	25
3	A	karrike	50
4	A	karrike	100
4	D	Vitrine e libr	10
5	D	Vitrine e libr	12

← PK →

kodi-Art	Emri-Art
A	karrike
B	tavoline
C	vitrine
D	Vitrine e librave

PK

Mabs hapit te 2^{te} te normalizimit tabela dhe relacionet gjinden ne ne formen e 2^{te} te normalizuar . Tani nuk kemi te dhena PJESERIShte TE MVARURA. Dhe tani munde te aplikojme edhe hapin e trete te normalizimit.



Microsoft Access 97/2000 per Windows

7.2.5. Hapi i 3^{te} i normalizimit

Mbas eliminimit te te dhenave plotesishte te mvarura , duhet qe te eliminojme edhe ato te dhena transitivishte te mvarura .

- Kerko fushat qe jane te mvarura nga nje fushe JO qelesore (psh. sektori dhe lokacioni)
- Formo nje relacion me keto te dhena dhe emero te dhenat kryesore si qeles. Ne kete shembull lokacioni eshte e dhene kryesore sepse sektori mvaret nga lokacioni e JO anasjelltas.
- Elimino te dhenat e mvarura (sektori) nga tabela apo relacioni i tanishem.

Klienti nr	Kl Emri	Lokacion i	Sektori
1	Luli	Prishtine	1
2	Agimi	Gjakove	2
3	Rroni	Prizren	2
4	Valdeti	Peje	3
5	Tringa	Prishtine	1

PK

SK

Lokacioni	Sektori
Prishtine	1
Gjakove	2
Prizren	2
Peje	3

PK



Microsoft Access 97/2000 per Windows

Mabs hapit te 3^{te} te normalizimit tabelat gjinden ne forme normale apo si perdoret termi ne boten e informatikes "shenimet e normalizuara" . Dhe se fundi siq shofim prej skemave te me poshteme baza e jone e shenime (Data Base) perfundimisht perbehet nga 4 tabela :

Klient i nr	Kodi-Art	Sasia
1	A	100
1	B	25
1	C	8
2	A	150
2	D	25
3	A	50
4	A	100
4	D	10
5	D	12

kodi-Art	Emri-Art
A	Karrike
B	Tavoline
C	Vitrine
D	Vitrine e librave

Klienti nr	Emri Kl	Lokacioni
1	Luli	Prishtine
2	Agimi	Gjakove
3	Rroni	Prizren
4	Valdeti	Peje
5	Tringa	Prishtine

Lokacioni	Spektori
Prishtine	1
Gjakove	2
Prizren	2
Peje	3

Shprehndarja e shenimeve neper tabela te ndryshme quhet normalizimi i permbledhjes se shenimeve. Wiskundig gezien betekent dit dat men een relatie vervangt door een aantal van zijn projecties.

7.3. Ushtrime - normalizimi

Normalizo tabel e meposhteme :

Nr-rexh	Tipi-vetures	Persh.vetures	Data transport.	Kodi-Art	Pershkr.ar t.	Sas.tran sp.
UHT162	C	Kamionet	02.01.98	TA, VT, KA	Tavolinel,vitrine, karrike	2, 4, 6
K500J	B	Kombi	05.01.98 en 09.01.98	KO	Kompjuter	50 en 38
ABX144	P	Veture udhet.	07.01.98	PR	Printer	6




Microsoft Access 97/2000 per Windows

8. FORMIMI I NJE DATABASE , HAPJA DHE MBYLLJA

Para se te filloni me formimin e tabelave, query-ve, formulareve dhe raporteve, se pari duhet nje database te formoni. Kjo database do te funksionoje si nje lloje konteneri i objekteve te ndryshme - qe kane per qellim te njejtin cak .

8.1. Formimi i nje database

- E startoni eventualishte Access-in .
- Kur te startoni Access-in iu paraqitet kjo dritare :




- Tani munde te zgjidheni per formimin(krijimin) e nje database te re ose per hapjen e nje database ekzistuese. Zhjidh **New Dtabase Using** 'Per formimin e database te re'; pastaj zgjidhe opcionin **Blank database** dhe kliko ne **OK..**
- Zgjidhe direktoriumin e sakte , shkruaje emrin e database ne rubriken **file name** (pa extension) dhe kliko ne **create** . Database tani formohet .
- Access-i iu tregon database dritaren . kjo dritare permbane te gjitha objektet qe do ti krijoni ne kuader te database qe e krijujat si psh. tabelat , query-t , raportet dhe formularet.
- Prej ketu ju mundeni edhe nje database te re te formoni permes menu **FILE / NEW DATABASE.**



Microsoft Access 97/2000 per Windows

8.2. Hapja e nje database existuese



- Starto (eventualisht) Access-in.
- Tek ky startim ju paraqitet prap database dritarja
- E zgjedhe database qe ju nevojitet nga lista , ose kliko ne **More files...** dhe kliko ne **OK**.
- Varesisht nga zhidja Database do te hapet .
- Database munde te hapet edhe permes menu **FILE/ OPEN DATABASE ...** Selektioni drive dhe direktoriumin e sakte , ku ne emrin e deshirueshlm me dubel e realizon hapjen e file -it perkates.

8.3. Mbyllja e nje database


- Nje Database munde te mbyllni permes meny **FILE / CLOSE**.

Aktivo kete komande, para se te ruash database. Normalisht te gjitha shenimet e duhura jane te shkruara ne disk para se perseri te vime te database . Accessin munde te mbyllni edhe me kombinimin e komandove nga tastatura Alt+F4.

8.4. Access dritarja

Gjate startimit te Access-it na paraqitet titulli (me tekst Microsoft Access + emri i database), meny kryesore, meny e punes dhe nje ekrane i lire dhe i zbrazet(hapsira e punes). Aktivitetet standarde te Windows rrethines perkrahen plotesisht nga Access-i si psh nderrimi i dimensioneve te dritareve , perdorimi i maus-it etj.

Meny -a




Ky eshte niveli me i larte i Access-it. Gjate startimit paraqiten vetem disa gjedhjet 'File' ...dhe 'Help'. Varesisht prej opcionit zgjedhore do te paraqitet menu-items. Shumica e opcioneve zgjedhore rezultojne me dritare percjellese. Keto dritare



Microsoft Access 97/2000 per Windows

percjellese shpeshehere i quajme dialog dritare, sepse ato e krijojne nje dialog mes jush dhe programit.

8.4.1. Meny e punes



Kjo meny gjindet nen meny kryesore. Meny e punes perbehet prej komandove qe ju mundesojne qasje te shpejte efekteve te ndryshme gjate punes . Te gjitha keto komando i gjeni edhe ne meny kryesore. Access ia pershtate situates momentale meny -ne e punes ; Pra shpeshehere ka pamje te ndryshme. Nese e vendoseni mausin ne kete meny dhe e shtypeni susten e djathte te mausit rezultati do te jete nje meny e shpejte me keto mundesi 'Database', 'Web' dhe 'Customize...'. Permes se cilave percaktoni se si do te duket ky meny dmth. Disa

Menyte e shpejta kane per detyre te na mundesojne aktivitete te ndryshme gjate punes (si psh. kopjimin, shkeputjen ose rivendosjen e tekstit apo te ndonje figure). Door middel van een dubbele klik op de werkbalk (best op het dubbele streepje) kun je deze verplaatsen. Je kunt er ook op klikken waarna je de linker muisknop ingedrukt houdt en de werkbalk vervolgens versleept.

8.4.2. Hapesira e punes

Hapesira e punes gjindet nen meny e punes . Kjo eshte nje pjese e Access-it qe vete duhet te administroni : hapja e database , krijimi i raporteve , shikimi i tabelave... Madhesia e Acces dritares e percakton perfundimisht madhesine e hapesires se punes.

8.4.3. Status Meny

Ky meny ofron informata per situaten aktuale , si dhe komandot e kursorit si psh. ScrollLock dhe NumLock.



Microsoft Access 97/2000 per Windows

9. HELP PROGRAMI

9.1. Versioni Office 97 (Access 8.0)

Help programi aktivohet permes meny HELP / Microsoft Access Help . Dhe na paraqitet nje dialog dritare me 3 kapituj .

9.1.1. Kapitulli 'Contents'

Ketu munde te zgjidheni disa tema te pergjitheshme .

9.1.2. Kapitulli 'Index'

Permes 'Index'-it munde te kekoni ndihme ne baze te nje teksti kerkues , Simbas mendimit tim ky kapitull eshte me i shfrytezueshmi ne asistimin e punes sone .

9.1.3. Perkraja e produktit

Nese dicka nuk eshte ne rregull me versionin e Access-it qe ju e posedoni , Permes 'HELP / Info' dhe opcionit 'about microsoft access', munde tre informoheni per perkrajen e produkteve qe jane zakonisht produkte te firmes Microsoft .

9.1.4. Komando

Me kete komando munde te informoheni shkurte per objektet qe jane prezente ne ekranin tone,me kushte qe objektit perkates munde te gjejme ne njerin prej menyve tone te Access. Ne menyre qe te shfrytezojme ndihmen e kesaj komando duhet te veprojmë si vijone: Se pari shtyp apo kliko ne komandon tone e pastaj kliko ne objektin per te cilin deshirojme informata .



Microsoft Access 97/2000 per Windows

10. KRIJIMI I TABELAVE

Proqesi i krijimit te tabelave ndryshe quhet edhe definimi i tabelave apo tabelave . Kjo dmth. Se ne vendosim se cilat kolona duhen te vijne ne tabelave dhe si duhen te duken keto kolona .

Jane dy metoda te krijimit te tabelave : metoda e pare Access-i i krijone vete permes programit te tij Wizard, kurse metoda e dyte ne i krijojme plotesisht tabelat . Perparesi ka metoda e dyte e krijimit te tabelave sepse vetem ne ate raste pra kur ne vete i krijojme tabelat kemi edhe kontrolle te plote ne to.


10.1. Krijimi i tabelave se re

Nese deshironi krijimin e nje tabelave te re , niseni nga database dritarja .Zgjidhe "Tables" database dritare.


■ Klike "New".

■ Ju paraqiten zgjedhjet e ardheshme :

■ Zgjedhjet me te rendesishme jane 'Tabel Wizard' dhe 'Design View'. Nese e ndiqni Wizardin Access-i do te ju ndihmoje shume ne krijimin e tabelave se re .Permes 'Design View' proqesin e krijimit te tabelave e keni plotesisht ne kontrollin tuaj.



Ne raste se jeni percaktuar qe vete te krijoni tabelen atehere Access-i automatikisht e aktivon ekranin e dizajni i





Microsoft Access 97/2000 per Windows

cili duhet ti ngjaje ekranit ne figuren tone .

Shiko meny aty jane tani item te ndryshem ne disponim .

Kur te perfundoje krijimi i tabelës , munde te kyqeni edhe ne vete table duke klikuar ne ikonën e tabelës qe gjindet prane diskut. Nese provoni qe te ikni nga design view Access-i do te ju pyes detyrimisht se krijimi i deri tashem i tabelës a duhet te ruhet ? . Heren e pare qe deshironi te shiqoni shenimet ne table ose te deshironi te ndrroni dicka ne table Access-i do te ju pyet per emrin e tabelës qe duhet ti ipet mbas dizajnit . Gjate emerimit te tabelës ju mundeni space(zbrazeti) te perdoreni . Mirepo eshte ide e mire qe emri i tabelës te filloje 'Tbl'.



Microsoft Access 97 per Windows

10.2. Dizajnimi i tabelës ose ndërrimi i structures së tabelës

10.2.1. Komandot disponuese në meny



Kalimi në dizajnimin e tabelës



Kalimi në shikimin apo ndërrimin e shënimeve në tabelë



Ruajtja e dizajnit, ruajtja e shënimeve në tabelë



Shtypja e shënimeve



Shembull i shtypjes



Kontrollimi i fjalive (nuk vlenë për gjuhën shqipe)



Shkeputja e pjesës së markuar dhe vendosja e sajë diku në memorje



Kopjimi i pjesës së markuar në pjesën që dojmë



Vendose pjesën e shkeputur apo atë të kopjuar



Perpunimi i kopjimit ose shkeputjes



Rikthimi i gjendjes të më parshme



Definon qelesin primare në fushat e selektuara



Hapë dritaren 'Indexe'-et



Vendose një rendë për një fushë të re



Asgjason rendin e selektuar respektivisht fushat



Hapë dritare 'Propertis' (karakteristikat - pasuria)



Starton Wizard-in



Kalon në database dritaren



Definon një objekt për tabelën aktuale



Rendite shënimet në bazë të fushës së indeksuar



Hapë dialog dritaren për definimin apo perpunimin e filtrit



Aktivon një filter



Asgjasone një filter



Hapë dialog dritaren 'Search' (kerko)



Vendose kursorin në një record(rendë) të ri



Asgjason recordin aktual



Vendosja apo perpunimi i një hyperlink-ut (adresat në www)






Tregimi apo fshehja e web-it (programet që kanë të bëjnë me www)



Microsoft Access 97/2000 per Windows

10.2.2. Symbolen bij het invoeren van records (gegevensbladweergave)

-  Recordi aktiv e cili ende nuk eshte nderruar
-  Recordi aktiv e i cili eshte ndryshuar
-  Recordi i zbrazet

10.3. Bazat e krijimit(dizajnit)

10.3.1. Dizajnimi i nje table na implikon ne :

- Emerimin e fuashave (kolonave);
- Percaktimi i permbajtjes se fushave (tipi i te dhenes);
- Pershkrimi i fushave (fakultative);
- Vendosja e formatit, rmaskahyrese, vlerat standarde dhe validimi i rendit;
- Percaktimi i qelesave primare dhe indekset.

10.3.2. Emri i fushes apo titulli i kolones

Ne fazen e dizajnit te tabelave Access-i i tregon kolonat e nje table si nje (radhe)rende. Cdo rende ne table paraqet ne te vertete nje fushe . Majtas afer kolones per emer te fushes gjinden indikatorët. Nje trekendesh e markon vazhdimisht fushen aktuale.

Ju keni nevojë për indikatorin edhe kur dhëshironi që një fushe të markoni (selektoni). Nëse dhëshironi që në të njëjtën kohë të markoni disa, perdoreni Shift ose me maus të shtypur kaloni neper fuashat që ju nevoiten. Kete duhet per shembull te beni kur doni te definoni qelesin primare i cili perbehet prej disa fushave. Qdo kolone ne table merr emrin maksimum prej 64 karaktereve. Ky emer munde te perbeje space(zbrazeti). Eshte me rendesi qe emrat e fushave te jene te qarte ose te permbaje saktesishte dometheninen e fushes.

10.3.3. Tipi i fushes

Përmes percaktimit të tipit të fushes percaktoni se qfare lloji informate munde të shkruhet në fushen perkatese (shifer, tekst,...). Në të njëjtën kohë percaktoni sa karaktere duhet të pranojë fusha dhe Access-i e bene rezervimin e fushes dhe permbajtjen e saj . Ju selektoni titpin e fushes prej listes ne kolonen e 2^{te}. Tipet e fushave që janë të njohura për Accessi-n i gjeni në tabelën e arheshme :

Lloi i te dhenes	Domethenia	Shfrytezimi i memories
Tekst	Per tekste maksimum 255 karaktere.	Maks. 255 bytes
Memo	Per tekste maksimum 65.535 karaktere .	Maks. 65.535 bytes
Number	Per numra.	1, 2, 4, 8 ose 16 bytes
Date/time	Per date dhe kohe. Format i percaktohet permes Start/Setings/Control panel. Vlerat	8 bytes



Microsoft Access 97/2000 per Windows

<i>Lloi i te dhenes</i>	<i>Domethenia</i>	<i>Shfrytezimi i memories</i>
Currency	per vit jane prej vitit 100 deri 9999. Per numrat ne formatin e valutes. Simboli i valutes percaktohet ne	8 bytes
AutoNumber	Start/Setings/Control panel. Per fushat numerike te cilat Accesi-i automatikisht i inkrementon(rrite) per nje. Kjo fushe quhet edhe auto-numeruesi	4 bytes
Yes/No	Per tebelet munde te shfrytezojme me se shumti nje auto-numerues.	
OLE-object	Fusha (booleane) me vlara (PO ose JO, E VERTETE ose JO E VERTETE)	1 bit
Hyperlink	Per Object-e me prejardhje nga ndonje tjeter Windows aplikacion.OLE-objectet nder te tjerash munde te permbajne fotografi , pjese muzikore ose tekste.	Maksimal 1 Gb
Lookup Wizard	Tekstet ose kombinim i teksteve dhe shifrave munde te perdoret si hyperlinkadrese, qe maksimalisht perbehet prej tri pjeseve ; pjesa 1 : Pasqyrimi i nje teksti ne nje fushe, pjesa 2 : path(rruga) ne drejtim te nje fajli (psh. URL), pjesa 3 : subadresa, lokacioni ne nje fajle ose faqe.	Maksimal 2048 bytes per pjese
	Permes pergjegjeve nga lista qe ju ofrohet percaktohet titpi i te dhenes per listen kerkuese ne te ardhmen .	

Tek shumica e tipeve te shenimeve mundeni te percaktoni edhe tjera karkteristika . Keshtu munde te percaktoni numrin e karaktereve qe do ti pranoje nje fushe tekstuale. Me tutje do te lexoni me shume per karakteristikat e fushave .

10.3.4. Pershkrimi

Kolonen e trete munde te perdorni per pershkrim me detaj te fushes . Ky pershkrim nga ana e Access-it tregohet ne statusline (Poshte ne ekran) kur tabela eshte duke pranuar shenime dhe kursori gjindet ne ate fushe.

10.3.5. Kalimi ne modusin e shikimit te shenimeve ose mbyllja e db dritares

Gjate modusit te dizajnit munde te kaloni ne modusin e shikimit te shenimeve(ku munde te shikoni , te futni shenime te reja , ti permirsoni shenimet) ose te mbyllni ato. Ne te dy rastet Access-i do t'ju pyet qe te emeroni tabelen e re . Dhe ne vazhdim Access-i do t'ju pyes se a do te deklaroni ndoj fushe si qeles primare. Ne



Microsoft Access 97/2000 per Windows

kete momente pergjigjuni me 'NO'; sepse me vone do te mirremi me kete qeshtje me detalishte.



Microsoft Access 97 per Windows

ID	1	2	3	4	5	6	7	8
Emri	Lulzim	Valdet	Tringa	Merita	Afrim	Zana	Edmond	Agim
Mbiemri	Hasani	Gashi	Berisha	Krasniqi	Rexha	Osmani	Balidelmaj	Limani
Adresa	Dardania 53	Lakrishte 12	Kodra e trimave 15	Ulpian 27	Dardania 525	Prishtines 12	Gjakoves 7	Tregut 85
Kodi Postal	38000	38000	29000	38000	25000	29000	Prizren	38000
Vendbanimi	Prishtine	Prishtine	Prizren	Prishtine	Peje	Prizren	Ferizaj	Prishtine
Telefoni	038/xxxxxx	038/xxxxxx	029/xxxxxx		02x/xxxxxx	029/xxxxxx		038/xxxxxx
Datelindja	17/06/66	24/02/71	26/03/65	05/06/63	27/09/58	14/02/69	21/07/40	11/04/58
I martuar	PO	JO	PO	PO	PO	PO	JO	PO
Femije	0	0	2	1	0	2	0	4
Paga	€ 750,00	€ 700,00	€ 850,00	€ 900,00	€ 750,00	€ 800,00	€ 750,00	€ 950,00
I punesuar	01/01/90	01/01/90	01/01/88	01/03/87	01/01/90	01/01/90	01/01/90	01/04/87
Spektori	Kontabiliteti	Kontabiliteti	Shitja	Drejtoria	Shitja	Kontabiliteti	Shitja	Drejtoria
Verejtje	Ploteso vete (memo)	Ploteso vete (memo)	Ploteso vete (memo)	Ploteso vete (memo)	Ploteso vete (memo)	Ploteso vete (memo)	Ploteso vete (memo)	Ploteso vete (memo)

Per te ditur formatin e nje fushe qe permbane informate te dates, shtyp CTRL komandon dhe njekohesisht shtyp ne (;). Ne ate fushe Access-i do tju tregojte daten e sotit ne format ne te cilin eshte percaktuar ne konfigurimin e windows-it.



Microsoft Access 97 per Windows

11. PUNA ME NJE TABELLE EKZISTUESE

11.1. Navigimi

11.1.1. Komandot

komand *Funksioni*

O



Aktivizon rradhen(rendin) e pare ne tabele.



Aktivizon rradhen(rendin) e fundit ne tabele.



Aktivizon rradhen(rendin) e meparshem ne tabele.



Aktivizon rradhen(rendin) e ardhshem ne tabele.



Aktivizon rradhen(rendin) e fundit ne tabele dhe mundesone futjen e shenimeve te reja.



Nese klikon ketu , munde te percaktoshe numrin e rendit ,dhe ai rende aktivohet automatikisht nga ana e Access-it.

11.1.2. Kombinimet ne tastjere

kombinimi *Funksioni*

Tab Aktivizon fushen e ardheshme.

Shift-Tab Aktivizon fushen e kaluar.

Home Aktivizon fushen e pare te kolones ne te cilen gjindemi. Nese e tere fusha nuk eshte e selektuar, dhe kusori gjindet ne mes te vleres , atehere nuk aktivizohet fusha e pare e kolones por kursori vendoset ne fillim te asaj vlere qe gjindeshim .

End Aktivizon fushen e fundit te kolones aktuale . Vepron vetem ne raste kur fusha eshte e selektuar.



Aktivizon rendin e kaluar (nese nuk i nderroni opcionet ne Tools - Options - Keyboard).



Aktivizon rendin e ardhshem (nese nuk i nderroni opcionet ne Tools - Options - Keyboard).

Ctrl-Home Aktivizon fushen e pare te rendit te pare.

Ctrl-End Aktivizon fushen e pare te rendit te fundit.

Ctrl+ Aktivizon fushen e pare te rendit te zbrazet.

Shift-F2 Hape Zoom(zmadhon) dritaren.

PgUp/PgDn Faqja e kaluar/ardhshme ne ekrane.

Ctrl:/Ctrl; Shkruan kohen/daten aktuale

Ctrl" Kopjon vleren nga fusha te kolones se njete te rendit te kaluar.


11.2. Plotesimi i nje tabele

11.2.1. Perfshirja e rekordeve(rendeve) te reja

Ne funde te tabelës zakonisht gjindet nje rekord i zbrazet. Ky rekord munde te njihet lehte sepse para shigjetes gjindet symboli i yllit



Microsoft Access 97 per Windows

Ne kete rekord munde te pozicionoheni shume lehte duke klikuar ne  . Kur nje here kursori eshte pozicionuar ne kete rekord te zbrazet simboli nderrohet ne simbolin e rekordit aktual (shigjete).

Dhe prej atij momenti munde te filloni te shkruani(shtypni). Gjate shkruarjes ne rekord simboli nderrohet dhe paraqitet simboli i lapsit . Ky simbol na bene te ditur se jemi duke ndryshuar ose futur shenime te reja ne rekordin aktuale, mirepo kjo nuk do te thote se keto shenime jane te ruajtura ne diskun magnetike. Definitivisht shenimet do te ruhen ne diskun magnetike ne menyre automatike ateher kur :

- ~ Kursori vendoset ne ndonje rekorde tjeter ose ;
 - ~ Te mbyllet tabela ose ;
 - ~ Perdorim kombinimin e tastieres SHIFT + (dhe) ENTER se bashku.
- ☺ Nese nje rekord eshte ruajtur e shenimet nuk jane si kemi deshירuar dhe deshirojme qe te kthejme gjendjen e meparshme te rekordit ateher , zgjidh *menjehere* ne meny 'Edit/Undo Saved Record' (**rikthimi i te dhenave**).
- Gjate perfshirjes mbrenda nje tabele mundemi te kushtezojme access-in qe ti tregojne ne ekran vetem shenimet e reja qe jemi duke i perfshire . Kete e arrijme permes meny 'Records/Dataentry'. E per me i bere prape te gjitha shenimet e tabelave te dukshme zgjedhim meny 'Records/Remove Filter - Sort'.

11.2.2. Permirsimi i te dhenave

Nese deshironi qe ti permirsoni te dhenat e gabuara , Keni keto mundesi :

- ~ Selektore pra vendose kursoren ne fushe, (kliko me de maus ne fushe, ne momentin kur treguesi i mausit e merr formen e kryqit) dhe sheno te dhenen korrekte. Kur ta leshon rekordin , permirsimet ne diskun magnetik do te behen automatikisht.
 - ~ Kliko me maus ne fushe , ashtu qe teksti te jete para kursorit dhe me komandot Delete ose Backspace elimino te dhenat qe eventualisht jane te teperta ose te gabuara . Edhe ne kete raste shenimet do te ruhen automatikisht ne diskun magnetik ne ate moment kur kursori kalon ne nje rekord tjeter.
- ☺ Gjate shkruarjes ne fushe , kur nuk dojme qe ndrrimet tona te kene efekte (te ruhen) mundeni thjeshte te shtypni komandon ESC ose te zgjidheni meny 'Edit/Undo Typing'. Perderi sa kursori gjindet ne rekordin aktual permes meny 'Undo/Current Record' mundeni qe shenimet ti ri kthejme.

11.2.3. Ushtrime

Tabelen 'Tbl Punetori' ploteso me shenimet nga faqja 27.

11.3. Konsultimi i nje tabele

11.3.1. Sortimi(renditja) e te dhenave

Ne raste nevojje tabela mundet edhe te sortohet . ky sortim ne te vertete eshte i perkohshem : kur ta mbylle tabelen , Access-i pyet se a doni ti ruani shenimet . kur te pergjigjeni me 'yes', ky sortim gjene vende permanent (kur te hapim tjeter here





Microsoft Access 97 per Windows

tabelen ajo na paraqitet ne ate rradhitje te sortimit); kur te pergjigjeni 'no' atehere Access-i nuk e ruan tabelen ne renditjen e sortimit por ne renditjen origjinale.

Per te sortuar vepro :

Selekto fushen ne baze te ciles doni te sortoni tabelen (kliko ne emrin e fushes);


kliko ne sort-Ascending ose sort-Descending (Komandot   ne meny per te percaktuar menyren e sortimit duke u ngritur ose zbritur vleren) .


Opcionin e njete e gjen edhe ne meny 'Records/Sort'. Nese deshiron qe sortimi te realizohet ne baze te dy ose me shume fushave atehere duke e mbajtur SHIFT te shtypur kliko ne fushat ne baze te te cilave do te behet sortimi i tabeles .

11.3.2. Gjetja e te dhenave(shenimve)

Nese deshiron qe fushet ose rekordet e caktuara ti gjesh ne baze te nje vlere te caktuar te nje fushe atehere vepron si vijon :

Nese e dine se ne cilen fushe eshte permajtja qe e kerkojme , vendose kursorin e mausit ne ate fushe;

Zgjidh 'Edit/Find' ose kliko ne ikonën e turbinjeve  ne meny;



Ne **find what** shkruaj tekstin ose vleren qe deshiron te gjeshe. Ketu munde te perdoresh edhe te ashtuquajtur **joker Parametrat** :

-> ? qfaredo karakteri
-> * nie ser

1. Kliko tek '**Match** :' dhe percakto njerin prej tri opcioneve te mundura te menyres se kerkimit , **qfaredo pjese** te fushes , **e tere** fusha apo **fillimi** i fushes. Kur te shkruajme 'Fat' ne dhe dojme te kerkojme me opcionin e **tere fushes** ,Access-i do te na tregojte vetem rekordet ku efektivisht gjindet teksti 'Fat'. Me kerkimin e opcionit **fillimi i fushes** Access-i do te na tregoi fushat ku gjinden psh teksti 'Fat' dhe 'Fatmire' kurse te kerkimi me opcionin **qfaredo pjese** te fushes Access-i do te na tregojte fushat qe permbajne tekstet psh. 'Fat', 'Fatmir' dhe 'Rifat'.
2. Tek opcioni '**Search**' keni keto mundesi te kerkimit ' Larte', 'Poshte' dhe 'Krejt'.
3. Per te percaktuar fushen(kolonën) ne te cilen do te kerkojme diqka , kliko ne opcionin '**Search Only Current Field**' . Ne raste tjera Access-i kerkon edhe ne fushat(kolonat) tjera.
4. Nese deshironi qe Access-i te gjeje ekzakte tekstin qe e kerkojme (sikur qe e kemi shkruar ne dritaren e kerkimit psh vetem shkronja te vogla ose te medhaja) e zgjedhim opcionin '**Match Case**' .




Microsoft Access 97 per Windows

5. Opcioni '**Search Fields As Formatted**' e perdorni kur kerkoni vlera qe permbajne formate te caktuara. Ky opcion perdoret per kerkimin e vlerave qe ruhen ne tabele ne njerin format kurse tregohen ne tjetrin format. Data ruhet ne formatin 'd-mm-vv' (psh.. 5-01-97), por eventualisht munde te tregohet ne formatin 'dd-mmm-vvvv' (psh.. 05-jan-1997).
6. Kliko ne komandon Find First per te filluar proqesin e kerkimit ; permes opcionit Find Next munde te kerkoni vleren e ardheshme .
- ☺ Ne raste kur e keni mbylle dritaren se kerkimit ,dhe keni nevojte qe te kerkoni te te njejten vlere qe ishit heren e fundite duke e kerkuar shtypni kombinimin e tastiereve Shift + F4.


11.3.3. Filtrimi i te dhenave

Ne raste kur nuk doni qe te gjitha rekordet e nje tabele ti shikoni , por vetem ato rekorde qe i pergjigjen nje kriteriumi te caktkuar perdoreni filtrimin e te dhenave. Permes filtrimit mundeni te realizoni edhe sortime komplekse . Njejte sikurse sortimi edhe filtrimi i shenimeve eshte i perkohshem.

11.3.3.1. Caktimi i nje filtri

Per te percaktuar nje filter kliko fushen e cila duhet te perdoret si filter dhe mepastaj kliko ne meny . Qka ngjane , Tani jane te dukshem vetem rekordet qe jane plotesishte te njejta me fushen e percaktuar si filter .

11.3.3.2. Eliminimi i Filtrit

Per ti bere te dukshme prape te te gjitha te dhenat kliko ne .

11.3.3.3. Percaktimi i Filtreve te formulareve (Filter By Form)

Me kete opcion munde te percaktoni kriteriume te shumeta te filtrimit. Ne qdo kolone keni mundesi te caktoni kriteriume nga lista zgjedhore qe iu ofrohet. Per te anuluar kete kriterium kliko ne komandon me kryq. Duke klikuar ne filter komandon tregon shenimet qe i pergjigjen te gjitha kriteriumeve me pare te caktuara ne filter. Duke klikuar ne eliminimin e filtrit prape shohim tabelen e tere me te dhena.

11.3.3.4. Teknikat e avancuara te filtrimit

Permes menu 'Records/Filter/Advanced filter dhe sort...' mundeni te caktoni kriteriume te shumta te filtrimit dhe sortimit te te dhenave. Pasi qe kjo teknike kerkon njeohuri te gjere te perdorimit te query-ve me vone do te mirremi me kete teknike.



Microsoft Access 97 per Windows

11.4. Percaktimi i karakteristikave te Tabelave

11.4.1. Tipi i shkronjave

Ne access tipin e shkronjave mund te percaktojme vetem ne nivel te tabelës. Pra nuk ka mundesi qe kolonat e ndryshme te permbajne tipe te shkronjave te ndryshme. Vetem te formularet munde te perdoreni dhe te tregoni tipe te ndryshme te shkronjave per kolona, rende ose fusha.

Permes meny 'Format/Font...' hapet dialog dritarja 'Font'. Zgjidhe tipin e shkronjave, nje madhesi te caktuar eventualisht efektete si psh **bold(e theksuar)**, Underline (e nenvizuar), *italic*, etj...

11.4.2. Lartesia e rendit dhe gjeresia e kolones

Lartesia e rendit e eshte Standard e caktuar dhe vlene per te gjitha rendet . Percaktimi i lartesisë se rendeve ehste interesante kur te punoni me tekste te gjata dhe kolona te ngushta , Nese e caktoni nje rende e gjeresia e kolonave nuk eshte e mjaftuar te pranoje tekstin e shtypur Access-i e ndane tekstin ne disa rende .

Per ta nderruar lartesine , vendose mausin ne kolone te tabelës(ne anen e majte) preciz mes dy rendeve . Treguesi i kursorit nderror formen dhe paraqitet si nje kryq me shigjete poshte dhe larte pija. Terheke mousin deri ne poziten e re te deshiruar .

I njeiti efekt arrihet edhe permes meny 'Format/Rowheight', Ku na paraqitet dialog dritarja 'Rowheight'. Lartesia e rendit aktual paraqitet ne pika . Qdo pike eshte e barabarte 1/72 inch (1 pike = 0,376 cm). Nese e markoni fushen 'Standardheight' , Access-i ia pershtate lartesine tipit te shkronjave aktuale.

Gjeresine e kolones munde ti caktoni qdo kolone pamvaresisht. Nese e vndose mausin ne titullin e kolonave preciz mes dy kolonave , ku treguesi i kursorit e nderron formen . kliko dhe maje te shtypur komandon e mausit dhe terhiqe vijen simabs nevojës(deshires) deri tek pozita e re .

Edhe ketu munde te veproni nga meny 'Format/Column width' permes dialog dritares te percaktoni gjeresine e re te kolones si dhe opcionin 'Standard Width' te markoni.

11.4.3. Bartja e kolonave

Kolonave mundeni lehte t'ju nderroni renditjen. Selektu nje ose me teper kolona ne ate menyre qe duke e mbajtur mausin e shtypur vendose kursurin ne poziten e re (para vijes vertikale paraqitet nje vi e trashe vertikale (liroje komandon e shtypur te mausit)dmth.aty vendosni kolonen e juaj dhe se aty eshte pozita e re e kolones).

11.4.4. Kolonat e padukshme

Ne raste kur nuk deshironi qe te gjitha kolonat e tabelës te jene te dukshme per shkak te ndonje perpunimi te caktuar keni mundesi qe nje apo disa kolona ti vendosni ne nje statut te padukshem (edhe pse kolonat nuk do te duken ato jane ende ne table dhe se ato nuk jane zhdukur ne asnje momente). Selektu nje ose me shume kolona dh zgjidh ne meny 'Format/Hide Columns'. Gjate perfshirjes se rekordeve te reja kto kolona mbeten te pa dukshme .



Microsoft Access 97 per Windows

Per ti kthyer kolonat nga statuti i padukshem ne ate te dukshem , zgjidh menyne 'Format/Unhide Columns'. Paraqitet dialog dritarja me listen e te gjitha kolonave nga tabela . Emrat e kolonave te padukshme nuk jane te markuara , Marko kolonat qe deshiron ti kthesh ne statusin e dukshemerise.

11.4.5. Bllokimi i kolonave

Me opcionin 'Format/Freeze Columns' Munde ti bllokoni kolonat e nje tabele ashtu qe ato te mbesin gjithmone te dukshme ne anen e majte te ekranit tone pa marre parasysh se sa large shkojme ne drejtimin e kundert , kurse me nje vije vertikale te trashe kufizohen me kolonat e pa bllokuara .

Me opcionin 'Format/UnFreeze All Columns' keto kolona deblllokohen, por mbaje ne mende se kolonat nuk rradhiten automatikisht . Pra rradhitja e meparshme nuk vjene ne menyre automatike , Nese ajo eshte e nevojshme ateherë duhet qe vete ti ri vendosni kolonat sikur u spjegua me larte .Mbas nderrimi te renditjes se kolonave duke e mbyllur Access-in iu shtrohet pyetja se a doni te ruani tabelen ne formen e re (ne rradhitjen e ndryshuar te kolonave) Nese nuk deshiron te ruash ate ndryshim , ateherë pergjigju me NO.

11.4.6. Shtypja e tabelës

Tabela mundet direkt te derhgohet ne shtypes duke klikuar ne ikonën e shtypsit ne meny . Ne kete raste tabela do te shtypit dhe do te paraqitet ne leter ne ate forme sikurse qe edhe duket ne tabele, pra Access-i kujdeset per renditjen e sortimit si dhe per filtrat.

Shtypja do te zhvillohet ne shtypesin standard qe e kemi paraqitur ne Windows 95/98. Nese gjerësia e tabelës qe duhet shtypur e tejkalon gjerësine e letres , shtypja realizohet ne disa faqe te letres. Eshte mire qe para se te dergoni shtypjen ne leter se pari te kontrolloni se si do te shtypen te dhenat duke klikuar ne ikonën afer shtypesit 'Print Preview'. Dhe me opcionet standarde te Windows-it mundeni te shfletoni materialin i cili do te shtypet ne leter. Nese jeni te kenaqur me formen e shtypjes ateherë klko ne meny 'Print' , materiali do te dergohet ne shtypesin te cilin e keni konfiguruar ne windows.

Per presentimin e te dhenave ne leter me se miri eshte qe te krijoni raporte. Si duhet te bejme kete do te shofim me vone.



Microsoft Access 97 per Windows

12. DIZAJNIMI I TABELES: TEKNIKAT E AVANCUARA

12.1. Karakteristikat e fushave

Gjate deklarimit të fushave në kuadrin e një tablele (tekst, numerik, valute,...), Access-i iu cakton vlera dhe karakteristika standarde. Pra ju ju mbetet vetëm të ndryshoni ato dhe t'i pershtatni nevojave tuaja. Shpeshere karakteristikat e fushave ndikojne në kualitetin e tabelës e njekohesisht edhe të database psh. është mire që fushat numerike që do të permbajne perqindje të ndryshme t'i tregojme në formatin e perqindjes psh. **30 %**.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhëna të gjitha karakteristikat e fushave që mund të përdoren për karakterizimin e fushave konkrete.

Karakteristika	Tekst	Memo	Nr	Date /Koh e	Valute	Auto num-erim	Po/Jo	OLE-object	Hype r link
Gjatesia fushes	e Po	Jo	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Formati	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Jo	Po
Vlera Standarde	Po	Po	Po	Po	Po	Jo	Po	Jo	Po
Rregull Validimi	Po	Po	Po	Po	Po	Jo	Po	Po	Po
Tekst Validimi	Po	Po	Po	Po	Po	Jo	Po	Jo	Po
E indeksuar	Po	Jo	Po	Po	Po	Po	Jo	Jo	Jo

12.2. Gjatesia e fushes

12.2.1. Gjatesia e fushes tek fushat tekstuale

Gjatesinë e fushes mund të përcaktoni vetëm tek fushat tekstuale dhe ato numerike. Tek fushat tekstuale gjatesia e fushes përcakton se sa karaktere mund të shkruhen në atë fushë. Access-i i ruan vetëm ato shënime të cilat janë shkruar në fusha (nëse e parashohim fushën prej 40 karaktereve dhe i kemi shkruar vetëm 5 Access-i do të rexhistroje në disk magnetike vetëm ato 5 karaktere që janë të shkruara). Tek fushat tekstuale gjatesia maksimale është 255 karaktere.

12.2.2. Gjatesia e fushes tek fushat numerike

Tek fushat numerike gjatesia e fushes përcakton madhësinë e numrit që do të shkruhet në fushë. Tipi i numrit përcaktone thellësinë dhe precizitetin e një fushe numerike, si dhe a do të përbejë ajo fushë decimale apo jo.

Tabela e mëposhtme pasqyron përmbledhjen e tipit të numrave.



Microsoft Access 97 per Windows

Tipi i numrit	Thellesia (qe ai numer munde te mberrije)	Decima let	Shfrytezimi i memories
Byte	Prej 0 deri 255	Jo	1 byte
Integer	Prej -32.768 deri 32.767	Jo	2 bytes
Long Integer	Prej -2.147.483.648 deri 2.147.483.647	Jo	4 bytes
Precizitet i nje fishte	Prej -3.4×10^{38} deri 3.4×10^{38}	Maks. 7	4 bytes
Precizitet i dy fishte	Prej -1.797×10^{308} deri 1.797×10^{308}	Maks. 15	8 bytes

Percakto tipin i cili do te jete i perdorshem per ju dhe i cili nuk perdore memorie te shumte pa nevojte. Access-i ju propozon si tip standarde 'Long Integer'.

Access-i posedone 3 tipe te numrave ku munde te memoroni numra te plote. Shif tablen tipi 'Byte' pranon vetem numra pozitive. Dhe kjo perdore me se paku memorie vetem nje byte.

Numrat e tipit Auto-number perpunohen ne menyre interne si fushe numerieke e tipit type 'Long Integer'. Kjo informate eshte e rendesishme kur deshironi te definoni referential integrity per fushat auto-number!

12.3. Formati i fushave

Me karakteristiken 'Format' percakton formatin (si do te duket e dhena ne fushe) e fushes. Ashtu qe psh .nje fushe numerike e tregojme si exponent. Me ndihmen e formatit tregon formate te ndryshme te te dhenave psh. si duhet te duket nr.i tel. , qfare ngjyre duhet te kene numrat pozitive dhe qfare ato negative.

Gjate formimit te tabelës apo fushes ju paercaktoheni per nje format te caktuar te cilin Access-i me vone e merr si format standard per ate fushe te caktuar ,nese me vone keni nevojte te dizajnoni formulare apo raporte per tregimin e fushave te ndryshme , shume rralle do te keni nevojte qe te ndryshoni formatin e ndonje fushe ne formulare apo raporte. Per ate aresye eshte shume me rendesi qe gjate definimit te formatit te zgjidhni me **kujdes** formen e cila me se shumti iu nevoitet.

12.3.1. Formatet Standarde

Access-i na jepe ne disponim nje sere standard formate, te cilat munde direkte te selktohen nga lista Tabela e me poshteme pasqyron formatet standarde.

Lloji i te dhenes	Formati	Pershkrimi
Tekst	Nuk posedon format standarde.	-
Memo	Nuk posedon format standarde.	-
Numerik	Formati standard i numrave	Ndane mijeshet me nje shenje dhe te gjitha decimalet e shtypura (psh.



Microsoft Access 97 per Windows

<i>Lloji i dhenes</i>	<i>te Formati</i>	<i>Pershkrimi</i>
	Currency	3456.789). Tregon mijeshet te ndara me nje shenje , dy decimale , dhe simbolin e valutes (psh. 3 456.50 €).
	Permanent	Tregon se paku nje shifer dhe dy decimale (psh. 3456.79).
	Standard	Ndane mijeshet me nje shenje dhe dy decimale (psh. 3 456.79).
	Percent	E shumezon vleren e shkruar me 100 dhe shton shenjen e perqindjes (psh. 123 %).
	Scientific(Shkencore)	I tregon numrat ne formatin shkencore ; Mbas shkronjes E 10 (psh. 3.46E +03)
Date dhe Kohe	Date/Time	Tregon kohen dhe/ose nje date (psh. 29/05/61 18:05:00)
	Long date	E tregon daten ne forme te gjate e cila caktohet ne windows Configuration(psh. 29 May 1961).
	Medium date	Tregon daten ne formatin dd-mmm-vv (psh. 29-May-61).
	Short date	Tregon daten ne formen dd-mm-vv (psh. 20-04-61).
	Long time	Tregon kohen ne forme te gjate e cila confinfigurohet ne windows (psh. 18:05:00).
	Medium Time	Psh. 06:05 PM.
	Short time	Psh. 18:05.
Currency	Shif numrat	-
Auto-number	Shif numrat	-
Hyperlink	Nuk posedon format standard	-

Perpos standard formateve , ekziston mundesia qe edhe vete te krijoni formate personale.

12.3.2. Definimi i formateve

12.3.2.1. TEKST dhe MEMO

Gjate definimit te formateve per fushat TEKST dhe MEMO munde te perdoren keto simbole.

<i>Symboli</i>	<i>Pershkrimi</i>
----------------	-------------------



Microsoft Access 97 per Windows

@	Nje tekst karakter (nje shkronje ose space(zbrazeti)) eshte i nevojshme.
&	Nuk ka nevoje per tekst karaktere.
<	I gjithë teksti tregohet ne shkronja te vogla.
>	I gjithë teksti tregohet ne shkronja te medhaja.

Definimi i formateve per tekst dhe memo fusha iperbehet prej dy sekcioneve. Qdo sektion perbane format per te dhenen e caktuar ne fushe.

<i>Sekcioni</i>	<i>Pershkrimi</i>
I pare	formati per fushat qe permbajne tekst.
I dyte	formati per fushat e zbrazeta.

Shembujt e ardhshem i takojne formateve ne fushat tekst dhe memo.

<i>Definimi</i>	<i>Rexhistrimi</i>	<i>Tregimi</i>
@@-@@-@@@@@@	3130316482	31-30-316482
@@@@@@@@@@@@	31-30-316482	31-30-316482
>	3130316482	3130316482
	prishtina	PRISHTINA
	Prishtina	PRISHTINA
	PRISHTINE	PRISHTINE
<	PRISHTINE	prishtine
	Prishtine	prishtine
	prishtine	prishtine
@;"I Panjohur"	Null-Vlere	I Panjohur

12.3.2.2. NUMERIK DHE CURRENCY

Me simbolet e ardhshme caktohen formatet ne fushat numerike.

<i>Symboli</i>	<i>Pershkrimi</i>
0	Theksim i perkohshem . Tregon nje shifer ose 0 .
#	Theksim i perkohshem . Tregon nje shifer ose asgje.
(€)	Tregon shenjen € (psh. € 10 000).

Keto formate munde te perbejne deri 4 sekcione , te ndara me nga nje pikeprese(;). Qdo sektion permbane specifikacion per nje tip te caktuar numerik.

<i>Sekcioni</i>	<i>Pershkrimi</i>
I pare	Formati per numra pozitive
I dyte	Formati per numra negative
I trete	Formati per 0 vlera
I katert	Formati per null vlera



Microsoft Access 97 per Windows

Formati standarde per valuta ka kete ndarje:

€ #.##0,00; € #.##0,00- (Euro).

Keto formate perbejne dy seksione, te ndara me nga nje pikeprese(;). Munde te perdoren formate te ndryshme per numrat pozitive (seksioni i pare) dhe numra negative (seksioni i dyte). Seksioni i trete dhe i katert nderpriten . 0 vlerat dhe Null-vlerat nuk tregohen ne ndonje menyre te posaqme.

Shembuj formatesh.

Definimi

0;(0);;"Null"

Pershkrimi dhe tregimi

Vlerat pozitive tregohen normalisht, vlerat negative futen brenda kllapave, nese vlera eshte e barabarte me 0 nuk tregohet asgje e nese vlera eshte e barabarte me nul atehere na tregohet teksti "Null" (Null vlera dmth. **Asgje** bile e "panjohur" edhe per kompjuter , keto jane zakonisht vlera binare.

+0,0[blue];-0,0[red]; 0,0 Vlerat pozitive tregohen me nje (+)perpara , kurse ato negative me nje(-) nese vlera eshte e barabarte me nul tregohet 0,0 . Vlerat apo numrat pozitive tregohen ne ngjyre te **kalter** krse ato negative tregohen ne ngjyre te **kuqe**.

12.3.2.3. DATE/TIME(data/koha)

Me simbolet e ardheshme munde te definoni formatet kohore .

Symboli	Pershkrimi dhe Tregimi
: (Dy pika)	Simboli i ndarjes kohore. Ky simbol vendoset gjate konfigurimit te Windows-it . Varesisht prej asaj se cili simbol perdoret ne sistemin operative na paraqitet edhe ketu.
-	Simbol i ndarjes datore. Ky simbol vendoset gjate konfigurimit te Windows-it . Varesisht prej asaj se cili simbol perdoret ne sistemin operative na paraqitet edhe ketu .
c	Me pare e definuar si format standard per data.
d	Dita e muajit nje ose dy shifrore, varesisht nga nevoja (Prej 1 e deri me 31).
dd	Dita e muajit (prej 01 e deri me 31).
ddd	Dy shkronjat e para te dites (mo, tu, we, th, fr, sa, su).(Per windows ne gjuhen Angleze).
dddd	Emri i plote i dites (prej "monday" deri me "Sunday"). (Per windows ne gjuhen Angleze).
dddddd	Me pare definuar ne formatin short date.
dddddd	Me pare e definuar ne formatin long date .



Microsoft Access 97 per Windows

<i>Symboli</i>	<i>Pershkrimi dhe Tregimi</i>
w	Dita e javes (prej 1 e deri me 7).
ww	Jva e vitit (prej 1 e deri me 53).
m	Muaji i vitit nje ose dy shifrore, varesisht nga nevoja. (prej 1 e deri me 12).
mm	Muaji i vitit dy shifrore (prej 01 e deri me 12).
mmm	Tri shkronjat e para te muajit (prej "jan" e deri me "dec").
mmmm	Emri i plote i muajit (prej "january" e deri me "december").
k	Tregon daten si kvartal te vitit (prej 1 e deri me 4).
y	Dita e vitit (prej 1 e deri me 366).
yy	Dy shifrat e fundit te vitit (prej 01 e deri me 99).
yyyy	Viti i plote (prej vitit 0100 e deri me vitin 9999).
h	Oret ne nje ose dy shifra, varesisht nga nevoja (prej 0 e deri me 23).
hh	Oret ne dy shifra (prej 00 e deri me 23).
n	Minutat ne nje ose dy shifra, varesisht nga nevoja (prej 0 e deri me 59).
nn	Minutat ne dy shifra (prej 0 e deri me 59).
s	Sekondat ne nje ose dy shifra (prej 0 e deri me 59).
ss	Sekondat ne dy shifra (prej 0 e deri me 59).
tttt	Me pare definuar ne formatin long time.
AM/PM	Ora-dymbedhjeteoreshe me shfrytezimin e shkronjave te medhaja AM dhe PM
am/pm	AM(para dite) dhe PM (mbas dite). Ora-dymbedhjeteoreshe me shfrytezimin e shkronjave te vogla am dhe pm
A/P	am(para dite) dhe pm (mbas dite). Ora-dymbedhjeteoreshe me shfrytezimin e shkronjave te medhaja A dhe P
a/p	A(para dite) dhe P (mbas dite). Ora-dymbedhjeteoreshe me shfrytezimin e shkronjave te vogla a dhe p
AMPM	a (para dite) dhe p (mbas dite). Ora-dymbedhjeteoreshe me indikimin par ose mbas dite , varesisht nga definimi qe eshte bere ne windows.

Vrejtje.

Nese deshironi qe ne formatin e juaj de futni nje presje(') atehere presjen e shkruani mes tojzave("") , per shembull : dddd", "d mmm yyyy.

Disa shembuj te formatit datore/kohore.

<i>Definimi</i>	<i>Tregimi</i>
dddd", "d mmmm yyyy	monday, 2 june 1996
dd mmmm", "yyyy	02 june, 1996
"Kjo eshte java e "ww	Kjo eshte java e 22
"Sot eshte dite e "dddd	Sot eshte dite e tuesday



Microsoft Access 97 per Windows

12.3.2.4. Fushat PO/JO

12.3.2.4.1. Formatet e definuara me heret

Tek karakteristika , 'Format' kemi ne disponim formate me heret te definuara te tipit boolean apo me fjale te tjera logjike 'Po/Jo', 'E vertete/Epavertete' dhe 'I kyqur/I q'kyqur'. Po, E vertete dhe I kyqur jane ekvivalente, Jo, E pavertete dhe I q'kyqur jane gjithashtu ekvivalente .

12.3.2.4.2. Formatet per fushat PO/JO

Formatetet e ketyre fushave perbejne prej nje deri ne tri seksione.

<i>Sekcioni</i>	<i>Pershkrimi</i>
I pari	Ky seksion nuk perdiret per fushat Po/Jo. Mirepo duhet te shkruani nje pike prese perkohesishte .
I dyti	Teksti qe gjindet ne vlerat Po-, e Vertete - ose I kyqur duhet te tregohet
I treti	Tekst qe gjindet ne vlerat Jo-, E pavertete ose I qkyqur duhet te

Ne shembullin e ardhshem defonojme nje format , ku fjala "Gjithemone" per vlerat Po-, e Vertete - ose I kyqur tregohet ne gjyre te kalter kurse fjale "Kurre" per vlerat Jo-, E pavertete ose I qkyqur tregohet ne ngjyre te kuqe .

;"Gjithemone"[Blue];"Kurre"[Red]

12.3.2.5. HYPERLINK

<i>Symboli</i>	<i>Pershkrimi</i>
<	I gjithë teksti tregohet ne shkronja te vogla.
>	I gjithë teksti tregohet ne shkronja te medhaja.

12.4. Input Mask

Kjo karakteristike na mundesone qe disa karaktere te caktuara te vendosen automatikisht ne fushe , ashtu qe ne nuk do te kemi nevojte ti shkruajme ato ne.Nder te tjerash munde te caktojme llojin e karakterit (shkronje ose shifer) dhe ne cilien pozite duhet te vendosen ato. Input Mask eshte e pershtatshme per fushat qe perbejne vlere te standardizuara . Nje shembull tipik eshte fusha qe mbane informaten e numrit te telefonit e e cila gjithmone ka strukturen e njejte .

Per definimin e nje input mask munde te perdoreni nje program ndihmes te accessit i cili quhet Wizard(Magjistari) dhe na udheheqe gjate proqesit te krijimit te ndone input mask. Per te perdorur Wizard-in , vepro :

■ vendose cursor-in ne fushen per te cilen dojme te krijojme input mask;



Microsoft Access 97 per Windows

■ kliko poshte ne karakteristikat e fushes INPUT MASK (kliko ne tri pikat);

■ Percjelli instrukcionet e Wizard-it.

Per te krijuar vete nje input mask , mundeni ti perdoreni simbolet nga tabela e me poshteme :

<i>Simboli</i>	<i>Pershkrimi</i>
Tekst	Shkruaje tekstin e caktuar (psh. '[' dhe ']')
permanent	
0	shifer (0-9, Shtypja eshte e obliguar, + plus dhe - minus nuk lejohen)
9	Shifer ose zbrazetire (shtypja nuk e shte e obliguar,+ plus dhe - minus nuk lejohen)
#	Shifer ose zbrazetire (shtypja nuk e shte e obliguar, gjate perpunimit zbrazetirat tregohen por nuk ruhen ne diskun magnetike, + plus dhe - minus nuk lejohen)
L	Shkronja (A-Z, shtypja e obliguar).
?	shkronja (A-Z, shtypja opcionale)
A	Shkronje ose numer (shtypja e obliguar)
a	Shkronje ose numer (shtypja opcionale)
&	Qdo karaktere ose zbrazeti (shtypja e obliguar)
C	Qdo karaktere ose zbrazeti (shtypja opcionale)
<	E gjithë shtypja tregohet ne shkronja te vogla
>	E gjithë shtypja tregohet ne shkronja te medhaja
!	Teksti rradhitet prej anes se djathte ne anen e majte ne vende se ndryshe.

Shembuj te input mask dhe lloji i vlerave qe munde te shtypen.

<i>Input Mask</i>	<i>Vlerat</i>
(000) 0000000	(020) 6770315
(999) 0000000!	(010) 3571855
	() 2245567
0000 LL	3581 AD
#999	-20
	2000
>L????L?000L0	EKALTER339M3
	MAY R 452B7
>L0L 0L0	T2F 8M4
00000-9999	98115-
	98115-3007
>L<??????????????	Mrika
	Rama
ISBN 0-&&&&&&&-0	ISBN 1-55615-507-7
	ISBN 0-13-964262-5



Microsoft Access 97 per Windows

>LL00000-0000

DB51392-0493

12.5. Description (Perskrimi)

Teksti që shtypet në 'Description', qëllimi kryesor i tij është që të përshkruajë përmbajtjen e fushës mirpo i njëjti tekst na paraqitet në funde të ekranit për të bërë të qartë se në cilën fushë gjindet kursori i pozicionuar.

12.6. Caption (Titulli)

Teksti që shtypet në 'Caption', ka për qëllim që të caktojë titullin e kolonës (Fushës) të kësaj tekst tregohet në krye të kolonës së tabelës.

12.7. Default Value(Vlera e parapare)

Në rast kur me heret e dini se një fushë e caktuar do të përmbajë vlerë standarde, ju mund të perkujdeseni që gjatë futjes së çdo rekordi të ri fusha për të cilën e kemi deklaruar në input mask të pranojë vlerë standarde.

Kështu që me këtë variant të input mask-ut keni mundësi që të atë fushë të ruani në disk ose për të ruani edhe të ndryshoni vlerën e saj standarde.

Sembull : Nëse deshironi që fusha të përmbajë vlerën e datës së sotme, Shtyp tek default value "=date()". Ky funksion i integruar në Access na tregon datën aktuale në fushën të kësaj, të cilën kemi mundësi edhe të ndërrojmë.

☺ Vlerat standarde të hyperlink-ut mund të përbehen prej një, dy ose tri pjesëve. Nëse deshironi të përdorim me shumë se një pjesë, atëherë ato duhet të ndajmë me simbolin '#'. Pjesa e parë është teksti të cilin deshironi të tregohet në database të kësaj, pjesa e dytë është internet adresa dhe pjesa e tretë është një pjesë e adresës ose ndonjë pjesë e caktuar e faqes në interneti. E tërë fjalia duhet të shkruhet me thojzave.

Shembull : "Faqja e Autorit#http://users.belgacom.net/gc299631#faqe2.html"

12.8. Validation Rule(Rregulla e validimit-(e vlefshme))

Me ndihmën e validation rule bene kontrollimin e vlerës hyrëse në fushën të kësaj. Validation rule është një shprehje logjike. Access-i do të pranojë vlerën hyrëse të fushës sone vetëm atëherë kur validation rule është e vertetë. Nëse validation rule nuk është e vertetë, tregohet teksti nga **validation text** dhe vlera hyrëse nuk pranohet në fushën të kësaj.

Validation rule duhet të përbehet se paku prej një operatori dhe një vlerë të caktuar.

Operatorët të cilët mund të përdoren :

= e barabartë me



Microsoft Access 97 per Windows

<>	e ndrysheshme nga
>	me i madhe se
>=	me i madhe ose i barabarte me
<	me i vogel se
<=	me i vogel ose i barabarte me
between ... And...	mes ndonje vlere te caktuar
... or ...	'or' logjike
Like .. .	Sikurse (i plotesuar me simbole te jokerit)

Si vlere munde te perdorni :

Vlera alfa numerike	te theksuara mes thojzave (psh. "Prishtine")
Vlera numerike	te shkruara normalisht
date/kohe	te theksuara mes simbolit # (psh. #01/01/1998#)

Jokeret munde ti perdorni :

?	nje karakter
*	nje sere karakteresh
#	nje shifer

Shembuj :

"Prishtine"	e barabarte me Prishtine
"Prishtine" or "Peje"	e barabarte me Prishtine ose Peje
>=1523	me i madhe ose i barabarte me 1523
Like "ta*"	vlerat qe fillojne me ta
Between 100 and 199	vlerat mes 100 dhe 199 (pra edhe 199)
<#01/01/1985#	datat para 1 janari 1985

Kujdese

Validation rule ekzekutohet :

- ~ Kure ne fushe keni rexhistruar ndoj informate dhe provoni qe nga fusha te kaloni ne fushen tjeter.
 - ~ Ose kur te behet ruajtja e rekordit (kure te provoni te kaloni ne rekordin tjeter). Nese vlere e dhene nuk kenaqe validimin tone , tregohet teksti validues, e nese nuk kemi caktuar tekst validues na tregohet nje vrejte e pergjitheshme (Standarde ne Access) .
- Nese tabela pson ndryshime permes query-ve ose importimeve automatike validimet nuk munde te ndikojne dhe eventualisht te kontrollojne ndryshimet qe behen.
- Nese keni caktuar validime , Jeni te obliguar qe ne ate fushe te rexhistroni. Ne raste ku deshironi qe fusha te mbetee e zbrazet dhe keni percaktuar rregullen e validimit per ate fushe, shtoni ne funde te validimit edhe kete shprehje "or is null" .



Microsoft Access 97 per Windows

12.9. Validation text (teksti i validimit)

Access-i tregon tekstin e validimit nese vlera hyrese e nje fushe nuk i plotesone kushtet ne rregullen e validimit . Munde te jepni vlere te rregullt qe e ploteson kushtin e validimit por mundeni qe procesin ta nderpritni duke shtypur ne Esc .

12.10. Required(I domosdoshem)

Nese ne karakteristiken required zgjedhim **yes** atehere jemi te obliguar qe te shkruajme ne ate fushe, perndryshe Access-i nuk na lejone qe te ruajme rekordin ose te kalojme ne rekordin tjeter .

Kjo shpesherehere kombinohet me rregullen e validimit.

12.11. Allow zero length(Lejo Zero gjatesi)

Kjo eshte karakteristike per tekst dhe memo fushat. Nese ne kete karakteristike percaktoheni per 'No' (Vlera standarde), atehere ne fushe nuk mundemi te vendosim 'nul karakterete'.Access-i bene dallim mes fushave qe nuk jane fare te plotesuara (null) dhe fushave me 'zero gjatesi' normalisht nese jeni percaktuar per kete opcione . Ky dallim eshte i rendesishem nese krijoni formate., ose kur shenimet jane ne relacion me ndonje query si dhe kur behet kerkimi i shenimeve .

Nese gjithesesi duhet te rexhistroni ndonje tekst ne fushe tekstuale ose memo pa shenime, ne ate raste shtyp ne fushe dy thojza nje mbas nje ("").

Shembull :

Ky shembull na mundeson te shofim dallimin mes personave qe nuk kane fare telefon dhe atyre qe kane por nuk e kemi rexhistruar ne tabele :

- ~ Nuk posedon telefon mos shtypni asgje ne fushe(null)
- ~ Numri i panjohur fusha pa shenime por me thojza("").

12.12. Indexed (i indexuar)

Me indeksimine e fushave te caktuara e shpejtesoni punen e access-it. Sidomos tek shfrytezimi i query vijne ne shprehje perparsite qe i ofrojne fushat e indexuara : sortimi, selektimi ose kerkimi ne baze te nje fushe te indeksuar funksionon me shpejte se sa tek ato te pa indeksuara , e sidomos kur kemi te bejme me tabela voluminoze.

Mirepo ne anen tjeter indkset munden edhe te ndikojne ne ngadalesimin e punes se Access-it : Kur psh. bejme permirsime ne fushat qe jane te deklaruar si index , mbas permirsimit Access-i duhet qe nderrimin e vlerave te indeksuara ta nderroje . Fushat qe munde te indeksohen jane te tipit : tekst, numerik, date/kohe ose valute. Per formimin e nje indkxi vepro si vijon :

■ Gjate krijimit te fushave(ose edhe me vone) selekto fushen qe done te indeksosh;

■ Tek karakteristikat e fushes kliko ne opcionin 'Indexed' ku munde te zgjidhni :

- ~ No Nuk eshte indeks;
- ~ Yes (duplicates Fusha indeksohet mirepo neper rekorde te



Microsoft Access 97 per Windows

OK)

ndryshme munde te rexhistrohen shenimet qe jane rexhistruar me pare dmth. Shenimi ne fushen(kolonen) tone nuk eshte unikat.

~ Yes (No duplicates)


Fusha indeksohet mirepo neper rekorde te ndryshme nuk munde te rexhistrohen shenimet qe jane rexhistruar me pare dmth. Shenimi ne fushen(kolonen) tone eshte unikat.

Indexed nuk jane te rendesishme vetem tek proqesi i sortimit ose i kerkimit te informatave , por luan rrole mjaft te rendesishem edhe tek vendosja e relacioneve mes tabelave te ndryshme ne kuadrin e nje database.

12.13. Caktimi i qelesit primare

Per qdo tabele duhet te krijohet qelesi primare. Perdorimi i qelesit primare e shpejteson qasjen ne shenimet e deshuruara ne tabelen tone dhe mundesone identifikimin unik te qdo rekordi ne kuader te nje tabele. Qelesi primare eshte njekohesishte edhe hyrje deri tek rekordet e tabeles dhe perdoret si fushe per nderlidhje me fushat qelesore te tabelave tjera.

Qelesi primare ka funksion shume te rendesishem . Ne Access munde te kemi nje qeles primare per tabele. Qelesi primare munde te formohet prej nje ose prej kombinit te disa fushave ne tabele, se cila fushe do te jete qeles primare ndryshon nga rasti ne rast, mirepo nje gje duhet te keni parasysh , **qelesi primare formohet prej atyre fushave qe e mundesojne identifikimin unik te nje rekordi ne tabele.**

Qelesi primare munde te definohet gjate dizajnit te tabeles . Selektu nje ose me shume fusha te cilat duhet te formojne qelesin primare dhe kliko ne komandon e qelesit t  .


Kure te mbyllni dritaren Access-i se pari kontrollon se a jane plotesuar keto kushte :

- A ekzistojne te dhena ne tabelen tone, nese te dhenat jane prezente vlerat e qelesit nuk guxojne te perseriten me shume se nje here ne tabele ;
- Access nuk pranone null-vlera ne fushat qe jane te deklaruar si qeles primare; kjo dmth. Se te gjitha fushat qe se bashku formojne qelesin primare duhen te permbajne te dhena ;
- Qelesi primare munde te formohet nga keto fusha : auto-numer , numerike-, tekst-, date/kohe- dhe valute.


Nese njera prej ketyre kushteve nuk plotesohet , Access-i nuk e pranon qelesin primare dhe ju kthene prape ne ekranin e 'Dizajnit'. Ne ato raste duhet te definoni



Microsoft Access 97 per Windows

qelesin primare duke kerkuar fusha tjera . Fushat qe formojne qelesin primare njihen lehte dhe bien ne sy sepse ne anen e majte ne ekranin e dizajnit kane shenjen e qelesit  .

12.14. Definimi i qelesit primare prej disa fushave

Sikurse qe e permendem me pare qelesi primare munde te formohet edhe me perdorimin e me shume fushave . Nese i selektoni disa fusha(duke e mbajtur shift te shtypur kliko ne fushat e deshiruara) dhe klikoni ne shenjen e qelesit  , Accessi formon qelesin primare prej atyre fushave. Pra shenimet mbrenda nje qelesi primare munde ti kombinojme. Tek kjo menyre e formimit te qelesit primare Access-i sorton shenimet, simbas rradhitjes se kolonave qe perbejne qelesin primare. Nese deshironi ndoj rradhitje tjeter ateherë ju duhet qe kolonave t'ju nderroni vendet. Tek formimi i qelesit primare prej disa fushave duhet te kontrolloni se a mos ndonjera fushe permbane null vlere . Qellimi eshte qe ky qeles te jete unik , Pra s'do te thote te kontrolloni secilen fushe veqmas por te gjitha fushat se bashku qe perbejne qelesin si teresi.

Per qdo fushe nga qelesi primare i perbere nga disa fusha munde te formoni qeles sekundare. Duke e marrur parasyshe se Access-i ne pergjithesi bene sortimin duke u nisur prej vleres se vogel kah ajo e larta ne baze te fushes se pare qe formon qelesin primare , nuk ka kuptime te formohet qelesi sekondare per fushen e pare te qelesit . Nese keni formuar qelesa sekondare per fushat e tjera te qelesit primare ateherë ato vijne ne shprehje ne rastet kur vlerat e kolones se pare jane te njeta (sortimi behet duke e marre parasysh qelesin sekondare) . Pra ketu ka vine ne shprehje definimi dhe perdorimi i qelesit sekondare.

12.15. Nderrimi i qelesit primare

Ka mundesi qe qelesi primare te nderrohet ne qdo moment. Kaloni ne ekranin e dizajnit 'Design view' dhe selekto fushat qe duhen te formojne qelesin primare. Dhe me pastaj kliko ne simbolin qelesit. Ne rastet kur per kete tabele jane te definuara relacionet , qelesi primare nuk munde te nderrohet. Mirepo nese kaloni ne ekranin e relacioneve (relationships) dhe i asgjasoni relacionet keni mundesi qe te nderroni qelesin primare.

12.16. Formimi i qelesit sekondare

Access-i formon automatikisht qelesa sekondare gjate kerkimit ne tabele. Qelesat sekondare e nxitojne kete proqes, mirepo kerkon kohe pake me te madhe dhe shfrytezon me shume hapësire ne disk gjate rexhistrimin te te dhenave. Per kete arsye duhet te analizojme mire se ne cilat fusha do te perdorim qelsa sekondare. Nese ne instancën e pare nuk keni definuar qeles sekondare per ndoj fushe te caktuar , dhe me vone paraqitet nevoja qe shpeshe te sortoni ne baze te asaj fushe , keni mundesi qe edhe me vone te definoni qeles sekondare per ate fushe. Qelsin Sekondare e formon ne ekranin e dizajnit permes karakteristikes 'Indexed'. Nese



Microsoft Access 97 per Windows

aty percaktoheni per 'Yes (Duplicates OK)', definoni qeles sekondare ku vlerat e qelesit do te perbajne vlara te dy ose shumefishta . Nese aty percaktoheni per 'Yes (No duplicates)', vlerat e qelesit duhet te jene unike. Perparesi fiton pra mundesia e pare. Qelesat sekondare formohen ne fushat autonumer-, numerike, tekst-, date/kohe dhe valute.

Nese nje fushe e keni deklaruar si qeles primare, Atehere Access-i automatikisht ia shtone karakteristiken po te njejtes fushe 'Yes (No Duplicates)'. Kete karakteristike nuk munde te nderroni, sepse nje fushe nuk munde te deklaroni ne te njejten kohe si unike dhe jo unike.

12.17. Dialog dritarja 'Indexes'

Qelesat sekondare te perbera prej disa fushave dhe munde te definoni vetem permes dialog dritares Hape dialog dritaren 'Indexed' me nje klik ne komandon



'Indexes'. Dialog dritarja 'Indexes' i tregon te gjitha qelesat e definuar si ata primare poashtu edhe ata sekondare. Kjo dritare jepe nje paqyrim me te mire te qelesave te definuar .

Dialog dritarja 'Indexes'

Index Name	Field Name	Sort Order
Secundair	EmriKlientit	Ascending
PrimaryKey	NumriKlientit	Ascending

Index Properties

Primary ☐ Yes
Unique ☐ Yes
Ignore Nulls ☐ No

The name for this index. Each index can use up to 10 fields.

perbene kolonat e indexeve , e emrat e fushave si dhe radhitjen e sortimit per qdo fushe qe kemi indeksuar. Access-i reXHistron automatikisht vetem ne fushen e pare emrin e indeksit.Ne te gjitha fushat tjera e indeksit qe perbehet prej disa fushave 'Index name' mbetet i zbrazet.

Ne pjesen e poshteme te dialog dritares Access-i tregone karakteristikat e qelesit te selektuar. Access-i markon qelesin aktual me nje trekendesh sikurse ne figure nalte. Karakteristikat e indekseve jane 'Primary', 'Unique' en 'Ignore Nuls'. Nese percaketone 'Ignore Nulls' **Yes** , gjate formimit te indexit access-i akcepton



Microsoft Access 97 per Windows

vetem rekordet me vlera ne fushat e qelesit. Rekordet me null-vlere nuk do te perfshihen ne indeks. Dhe ne kete menyre munde te kurseni hapsiren e diskut .

Vrejtje: Ketu tregohen mundesite e shfrytezimit optimal si te Access-it ashtu edhe te njesive periferike ne kete raste diskut magnetike , mirepo ne ditet e sotme e sidomos ne ato te ardheshme mediumet per ruajtjen e shenimeve nuk paraqesin problem serioze , sepse kompjuteret(shtepiak) e gjeneratave te reja vijne me disqe me nga disa Gigabyte memorie e ka raste qe hasim edhe ne terabyte, pra keshilla ime eshte nese mendoni se qelesat do te jene me te perdorshem duke u lejuar Null vlere ateher mos kurseni ne hapsiren e diskut magnetike.

Vlerat e mundeshme :

- 'Primary' perdoret vetem per qelesa primare;
- kurse per qelesat sekondare 'Primary' ka vleren 'No';
- 'Unique' ia cakton gjithmone qelesit primare vleren 'Yes';
- 'Ignore Nuls' tek qelesit primare gjithmone ka vlere 'No';



Microsoft Access 97 per Windows

13. VENDOSJA E RELACIONEVE MES TABELAVE

Tani ju edini se access-i eshte nje mekanizem relational 'Relational Database Management System', qka do te thote se mes tabelave te ndryshme mundeni te vendosni relacione(**lidhje**). Ne baze te ketyre relacioneve Accessi - i kerkon automatikisht informatat ne tabelat tjera(nese kjo eshte e nevojshme). Ju mundeni qe ti tregoni informatat si nje bashesi nga tabelat e ndryshme me perdorimin e nje selection query, nje formulari apo nje raporti.

Ne paragrafet e ardhshem do te shifni se si te dhenat(informatat) nga tabelat e ndryshme munde te "bashkepunojne" me ndihmen e relacioneve qe vendosen ne Access.

13.1. Kuptimi i relacioneve

13.1.1. Relacioni one-to-many(nje-ndaj-shume)

Relacioni me i shpeshte mes tabelave eshte one-to-many . Ky relacion implikon qe qdo rekorder ne tabelen A (e quajtur tabelle primare) **munde** te kete rekorder te ndryshem(disa) te njejte ne tabelen B (e quajtur tabelle e relatuar).


Anasjelltas qdo rekorder nga tabela B munde te kete **maksimum nje** rekorder te njejte ne tabelen A. Kjo rezultone qe qeles primare i tabeles A te jete lidhje mes ketyre dy tabelave.

Shembull

Ne nje tabelle e quajtur 'Tbl Personeli' perban shenime per personelin e nje firme ku qdo anetare personeli eshte unik dhe eshte rexhistruar **vetem nje here** , mirepo secili anetare munde te rexhistroje kurse te ndryshme (te paraqitura ne tabelen 'Tbl Kurset). Linku(lidhja) mes ketyre dy tabelave eshte numri rendore i anetarit te firmes i cili caktohet ne momentin e rexhistrimit te qdo anetari ne tabelen e personelit . Dhe ne te vertete ky numer rendore eshte edhe qeles primare ne tabelen primare 'Tbl Personeli'.

Figura :

Qeles Primere :
NUMRI RENORE





Microsoft Access 97 per Windows

13.1.2. Relacioni one-to-one(Nje-daj-nje)


Relacioni one-to-one ka tjetër kuptim dhe domethenie . Ky relacion implikon që qdo rekorde në tabelën A ka vetëm e vetëm një rekorde të njëjtes në tabelën B dhe anasjelltas. Ky relacion shpesh herë është i tepert : Sepse të gjitha këto shënime mundemi me i vendosë në një tabelë .

Shembull

Kemi në disponim një database me shënime të personelit. Një pjesë e këtyre shënimeve është publike (një pjesë të këtyre shënimeve mundë të qasen të gjithë) : adresa, mosha, etj... Pjesa tjetër e shënimeve është sekrete (Pagesat ...).

Për të zgjidhur këtë problem duhet të krijojmë dy tabela , që dhe në bazë të numrit personale (që është qelës primare në të dy tabelat) vendosim relacionin one-to-one.

Figura :



13.1.3. Relacioni many-to-many(shume-ndaj-shume)

Ky relacion nuk mundë të aplikohet në Access. Mirepo ekziston menyra se si mundë të zgjidhet kjo mungesë e access-it. Mes dy tabelash ku duhet të ekzistojë ekziston relacioni many-to-many e formojmë një tabelë të re, pra tabelën e tretë (e quajtur tabelë relacioni) . Përmes kësaj tabelë relacioni që e kemi formuar vetë, e detyrojmë Access-in që të improvizojë unitetin e qelësve primare .

Shembull

Hapi i parë :Kemi një tabelë me libra dhe një me autore të librave . Është e qartë se një autore mundë të shkruaj disa libra, Normalisht mendohet se tabela me autoret është tabelë primare kurse tabela e librave është tabelë e relatuar (relacioni one-to-many). Mirepo nëse e dime se disa autore mundë të shkruajnë librin e njëjtes !!!, problem !. Pra një libër nuk është në relacion me një autore , por mundësisht me shumë autore . Dhe prej këtij momenti shfaqet relcioni many-to-many. Zgjidhja për këtë lloj problemi , është : **Hapi i dytë** të formohet një tabelë me dy kolona : me qelësin primare nga tabela A dhe me qelësin primare nga tabela B. Kurse qelësi primare i kësaj tabelë do të përbehet prej dy kolonave të veta .

Hapi i parë :



Microsoft Access 97 per Windows

Qelesë primare :
Numri i autorit

Tbl autoret

Qelesë primare :
Numri i librit

Tbl librat

Zgjidja Hapi i dytë :

Qelesë primare :
Numri i autorit

Tbl autoret

1



Tbl librat e
autorit



Qelesë primare :
Numri i autorit +
Numri i librit

Qelesë primare :
Numri i librit

1

Tbl librat

Vetem në këtë mënyrë mundemi të veprojme dhe të jemi të sigurtë se uniteti i shënimeve edhe me tutje do të ruhet .

Autori	Emri
1	Boyce
2	Codd
3	Claus

Autori	Emri
1	1
2	1
3	2

Autori	Emri
1	Normalizimi
2	Te dhenat



Microsoft Access 97 per Windows

13.2. Formimi(krijimi) i relacioneve

Per te vendosur tabelat ne relacion vepro :Hape database dhe nga meny **tools** dhe selekto ' Relationships...'. Ju paraqitet dritarja e zbrazte e relacioneve.

Keto komando jane te redeshme :



Hape dialog dritaren view ne tabele.

Tregon relacionet standarde dhe direkte te nje tabele ose query.

Tregon te gjitha standard relacionet ne kuader te database-it.

Asgjason permbajtjen nga dialog dritarja relationships .

13.2.1. Rexhistrimi i Tabelave dhe/ose query-ve ne dritaren e relacioneve

Nese kurre me pare nuke e keni hapur dritaren **relationships**(e relacioneve) e me pare keni krijuar nje database ose keni be rexhistrimin e rekordeve, modeli i shenimeve eshte i zbrazet. Atehere Access-i hape automatikisht nje dritare ku mundeni ti futni tabelat dhe/ose query-it.

Dritarja 'Show Tbal' perbane listen e te gjitha tabelave , query-ve ose te te dyat nga databse aktuale. Ju munde qe ti futni tabelat dhe query-it duke klikuar dy here ne emrin e tyre nga lista.

Ju mundeni gjithashtu nje emer te selektoni dhe me pastaj te klikoni ne 'ADD' . Pasi qe i keni futur tabelat ose query-it ne te cilat doni te formoni relacione , mundeni kete dritare ta mbyllni. Kete dritare mundeni me hape sa here qe te keni nevojë edhe permes shtypjes se komandos se djathte te mausit → 'Show Table...').

13.2.2. Caktimi i relacioneve

Nje relacion caktohet gjithemone permes fushave referuese te dy tabelave . Para se te definohen relacionet , duhet te dini se cila tabele eshte primare dhe cila eshte sub tabele(sekundare) .Se pari futni tabelat si u pershkrua me larte permes dritares se relacioneve e pastaj duke e shtypur komandon e majte te mausit mbi fushen referuese te tabelës primare terhiqni mausin ne drejtimin fushes referuese te sub tabelës dhe lironi komandon e mausit.

Pasi qe e lironi komandon e mausit ,Access-i hape automatikisht nje (dialog) dritare te relacioneve ku munde te definoni edhe disa karakteristika tjera , sikurse ate te lidheshmerise.

Larte ne dritare shifen dy fushat referuese : ne anen e majte qendron fusha etabeles primare kurse ne ate te djathten ajo e sub tabelës . Nese nuk e keni selektuar fushen e duhur , Kete mundeni ende te ndryshoni. Kliko ne shigjete dhe selekto fushen e duhur.

Gjate definimit te relacioneve dhe definimit te integritetit referencial duhet te keni parasysh :

■ Fusha referuese e tabelës primare duhet te jete qeles unik ; Qelesat primare tregohen te theksuar ne listen e fushave ne tabele;



Microsoft Access 97 per Windows

■ Fushat referuese ne te dy tabelat duhet te perbejne te dhena te tipit te njejte dhe duhen te kene gjatesine e njejte. Mabni ne mende se Access-i fushat auto-number i ruan preciz si fusha numerike te tipit Long Integer;

■ Per te shpejtesuar proqesin e kerkimit ne tabela, me se miri eshte te definoni qelesa sekondare per fushat referuese ne sub tabele .

Opcionin 'Enforce Referential Integrity' e markoni kur deshironi qe gjate rexhistrimit te te dhenave ne tabele te behet kontrolli i rexhistrimit. Ky opsione eshte shume i preferuar pasi qe e dime se Access-i de RDBMS dhe se i njeh nderlidhjet qe krijohen ne query , raporte dhe formulare.

Opcionet 'Cascade Update Related Fields' dhe 'Cascade Delete Related Fields' munden te kyqen ose te q'kyqen. 'Cascade Update Related Fields' do te thote se nese ndryshohen vlerat e fushave ne qelesin primare te tabelës primare , Access-i do ti ndryshoje keto vlera edhe ne fushat e relatuara te tabelës/tabelave te relatuara. 'Cascade Delete Related Fields' do te thote se nese asgjasohen vlerat e fushave ne qelesin primare te tabelës primare , Access-i do ti asgjasoje keto vlera edhe ne fushat e relatuara te tabelës/tabelave te relatuara. Ky opcion eshte shume i preferuar.

13.2.3. Nderrimi i nje relacioni

Nese nje relacion nderroni, kliko dy here ne vijen e relacionit per te selektuar ate ose kliko ne meny 'Relationships → Edit Relationship...' dhe selekto fushat e relacionit.

13.2.4. Asgjasimi i nje relacioni

Relacionet munde te asgjasohen permes menyse kryesore ose permes menyse se shpejte (kliko ne komandon e djathte te mausit). Gjithashtu mundeni qe te klkoni ne vijen lidhese te nje relacioni dhe me pastaj nga tastjera te shtypni komandon Delete .

13.2.5. Join-karakteristika

Nese shtypni komandon 'Join Type...' te dialog dritares 'Relationships' Accessi hape nje dritare te re me 'Join-karakteristika'. Ne kete dritare caketone Access-i se cilat relacione standarde duhet te te pranohen.

Opcioni i pare eshte vlera standarde. Tek kjo menyre e lidheshmerise , mirren parasyshe vetem rekodet e njejta ne te dy tabelat (fushat qelesore duhen te kene vlera te njejte ne te dy tabelat qe jane te vendosura ne relacion).

Perpos kesaj forme te nderlidheshmerise ekzistojne edhe dy forma te tjera nderlidheshmerie. Te cilat mundesojne tregimin e rekordeve nga njera ose tjetra tabele edhe nese nuk kane ngjashmeri ne fushat qelesore qe referojne ne tabelen tjetër.

Shembull :



Nje database perbehet prej tabelës se klienteve 'Tbl Klientet' dhe tabelës se fakturave 'Tbl Fakturat'. Per qdo kliente nuk behet fakturimi (pasi qe ata nuk kane be prosina). Tek opcioni i pre do te tregoheshin vetem rekodet e atyre klienteve qe




Microsoft Access 97 per Windows


kane bere porosina(pra qe gjinden ne tabelen e fakturave).Kurse me ndihmen e dy opcioneve te tjera munde te tregojme edhe ata kliente qe nuk kane bere fare porosina(pra qe nuk eshte fakturuar per ta).

13.2.6. Tregimi i relacioneve

Dritarja relationships tregon relacionet ashtu si i kemi ruajtur heren e fundit. Nese deshironi qe ti shiqoni te gjitha relacionet ne kuader te nje database , kliko ne komandon e menyse 'Show All Relationships'  . Kete komando munde te aktivoni edhe nese e shtypni komandon e djathte te mausit. Nese jeni te interesuar ne relacionet e vetem nje tabele ose query, selekto dritaren e relacioneve dhe shtyp komandon 'Show Direct relationships'  . Access-i tregone te gjitha relacionet e tabelas ose query-t te selektuar .

Ka mundesi qe ne raste te nevojës te asgjasethabela nga kjo dritare . Kjo nuk ka asgje te beje me shenimet ne tabele ose me mirepo ka ndikim vetem ne pasqyrimin momentale. Kete efekte e arritni duke klikuar ne titullin e tabelas (pjesa e perhimte qe figurone emri i tabelas) dhe me pastaj shtypni komandon delete nga tastiera .

Nese deshironi qe perseri ti tregoni te gjitha relacionet , kliko ne komandon  'Show All Relationships' ne meny kryesore.

Kete pasqyrim te relacioneve munde te ruani duke zgjedhur 'File → Save' ose duke klikuar ne  diskete .



Microsoft Access 97 per Windows

14. KEMBIMI I TE DHENAVE MES APLIKACIONEVE

Ne access munde te perdorni te dhenat qe kane prejardhje nga aplikacionet tjera ose tjeter Access database. Ne anen tjeter shenimet e accessit munde te shkruhen ne njerin ose tjetrin format si dhe munde te dergohen ne aplikacione tjera .

14.1. Importimi i file-it (Tabeles)

Nese importoni nje tabele, Access-i bene konvertimin(pershtatjen) e tabeles qe importon ne formatin e Access tabeles. Jo qe munde vetem te importoni tabela me format te ndryshem por ka mundesi qe te importohen edhe shenimet qe jane te formatit si psh. faqet ne Excel ose ne Word.

Perparesia e Importimit eshte se qdo tabele e importuar do te kete rrolin e njejte sikurse qdo Access-tabela e rendomte. Per te importuar nje se pari duhet hapur nje database e me pastaj te zgjidhet na meny 'File → Get External Data → Import'. Hapet dialog dritarja 'Import' . Ne kete dritare paraqitet lista e formateve te file-ve qe munde te importohen. Zgjidhe nje emer prej listes : Microsoft Access, file-tekstaul, Microsoft Excel, dBASE III, dBASE IV, dBASE 5, ODBC-database ose nje HTML dokumente (nga nje here Lotus 1-2-3, Foxpro dhe Paradox-file mvaresisht prej versionit).

Pas selektimit te nje formati , selektoni emrin e file-it qe deshironi te importoni dhe Kliko ne 'Import'.

Tabelat e Word dokumenteve duhet se pari te dergohen(te kopjohen) ne nje excel file me opcionet standarde te windows-it Copy dhe Paste e me pastaj prej excel-it te behet importimi ne Access .

14.2. Kembimi i objekteve

Ne Access ka mundesi qe tabelen e nje database tjeter t'ia bashkangjiteni database-it qe jeni duke e perdorur . kjo do te thote se nje tabele munde te perpunohet nga dy database te ndryshme. Perparsia e bashkangjitjes ne krahasim me iportimin qendron aty se tabelat e bashkangjitura ekzistojne vetem nje here. Pra te gjitha nderrimet nga te dy database behen vetem ne nje tabele , qka nuk eshte rasti me tabelat e importuara.

Zgjidh meny 'File →Get External Data → Link Tables...' zgjidh prej listes se formateve te file-ve te cilat munde te bashkangjiten ne Microsoft Access. Access-i i tregon file qe i ka gjetur ne direktoriumin e caktuar . Seleкто database dhe me pastaj tabelen qe don me e bashkangjitur.

14.3. Sa per informate

☺ Permes importit perpos tabelave, mundeni edhe query-t, formularet ose raportet te importoni.



Microsoft Access 97 per Windows

14.3.1. Eksportimi i file-ve

Permes meny-se 'File → Save As/export...' mundeni qe te dhenat prej Access-it ti rexhistroni ne formate te tjera (te huaja) , ashtu qe munde t'ju qaseni me programe tjera.

14.3.2. Transferimi i te dhenave ne Word dhe Excel

Nese deshironi qe te dhenat e Access-it ne te cilat jeni duke punuar ti transferoni menjeher ne Word ose Excel, veproni si ne Eksportimi i file-ve dhe zgjidh nga lista word ose excel .



Microsoft Access 97 per Windows

15. PUNA ME QUERY

Ne shumicen e rasteve kur te konsultoni nje database , do te jeni te interesuar vetem per nje pjese te caktuar te shenimeve nga tabela/t : do te deshironi qe vetem nje numer te caktuar te kolonave te shifni ose do te deshironi ti shifni te dhenat qe e plotesojne nje kriterium te caktuar .

Ne ato raste duhet te dizajnoni **select query**. Select Query eshte nje sistem qe na mundesone qe nje grupe te dhenash nga tabela/t te veqojme. Rezultati i ketij query quhet **dynaset**.

Nese ne rekordet e dynaset behen ndryshime apo permirsime ato rekorde do te ndrrohen edhe ne tabelen origjinale.

Rezultati i query-t eshte pike dalese per formulare dhe raporte. Mes tjerash me query munde te nderlidhen tabelat ku nuk jane te definuara integritetet referenciale (ne raste te shumta nuk do te ishte ide e mire).

Select query, perdoret per selektimin e informatave nga nje table,dhe qendrone ne kundershtrim me Update Query , i cili perdoret per perpunimin(ndrrimin) kolektiv te informatave ose per asgjasin e tyre.

15.1. Dizajnimi i select query-t

Gjate krijimit te nje select query munde te perdoren query-wizards. Keto jane te preferueshme per krijimin e disa tipeve specifike te query-ve . Ne shumicen e rasteve query-t do ti krijoni pa ndihmen e wizard-it .

Per formimin e nje select query , duhet te nderrmerrni keto hapa :

- Fillo nga database dritarja;
- Selektto panelin **queries**;
- Kliko ne komandon **new**;
- Kliko ne komandon 'Design view' dhe kliko ne **OK**;
- Query dritarja hapet ne modin e dizajnit , ketu paraqitet lista e tabelave nga te cilat duhet te bazohet query;
- kliko ne tabelen ose tabelat e deshiruara ;
- kliko ne komandon **Add** ;
- kliko ne komandon **close** .

Ne gjysmen e pare te ekranit na paraqiten tabelat dhe fushat e tyre prej te cilave munde te krijojme query.Gjysma e dyte e ekranit quhet **queryraster** .

Meny ne query-dritare :

Komando Domethenia



Kalon ne modusin e dizajnit, SQL-, ose i tregon te dhenat nga query.



Rexhistrone query-in ne disk (eventualisht ne diskete).



Microsoft Access 97 per Windows



Ekzekuton query-n.



Hape dritaren 'Show Table'.



I tregon funksionet ne modusin e dizajnit.

All

Caktojme perqindjen e tregimit te rekordeve (default All).



Hape dialog dritaren 'Properties'(karakteristikat).

15.2. Karakteristikat e nje query

Ne query nuk rexhistrohen te dhena. Nje query perdore te dhenat prej nje ose me shume tabelave ne database me shenime . E gjithashtu edhe kur definohet query qe perdore rezultatet e ndonje tjeter query, mbesin te dhenat ne tabela e jo ne query. Nje query pra tregon te dhenat e caktuar nga nje ose me shume tabela , mirepo ato nuk i ruan per vete.

Gjate ekzekutimit te query-i Te dhenat nga tabela/t analizohen ne query . Ka mundesi qe te selektohen rendet , kolonat, te behet grupimi dhe perpunimi i te dhenave. Edhe pse rezultati i queryt i perngjane tabelës ne duhet te dime se aty ka dallim . Dallimi me i rendesishem eshte se ne query nuk ruhen te dhenat.

Rezultati i nje query quhet query-selection ose dynaset. Nje dynaset ka formen e nje table, me fjale te tjera rezultati perbehet nga fushat (kolonat) dhe rekordet (rendet) e tabelës ose tabelave .

Ne momentin e ekzekutimit te query-t, Access-i i kerkon te dhenat e nevojshme dhe i vendose ne nje lloje table te perkoheshme duke ia afruar shfrytezuesit ne disponim. Shpeshe here perpunimet e ndryshme behen ne rezultatin e query-t . si psh. rexhistrimi i te dhenave te reja ose asgjasimi i atyre ekzistuese. Ne praktike access-i i bene keto ndrrime ne tabelat ne te cilat eshte i bazuar query.

Ne raste kur nje query ruhet(rexhistrohet ne disk) , duhet te kemi parasysh se eshte bere vetem ruajtja e definimit te query-t e jo edhe rezultati se bashku me te. Ne te vertete edhe rezultati munde te ruhet mirepo jo si query por si table e posaqme te ciles ia caktojme nje emer e te njejten me vone munde te perdorim.

Nese mbyllet query dritarja , zhduket edhe query-rezultati , mirepo kjo mundet qdo moment te rikonstruktohet duke e hapur query-n e ruajtur dhe duke e ekzekutuar ate.

Query-t kane perparesi te madhe sepse ato gjithmone jane up-to-date(te azhuruara , me shenimet e fundit). Nje Query analizone tabelat dhe zakonisht i perpunone te dhenat ne menyre automatike. Shembull, definohet nje query qe bene kalkulimin e shpenzimeve gjate tere vitit. Kur te ekzekutohet query , pa marre parasysh se a jemi ne muajin janare apo dhjetore ai e bene kalkulimin e shpenzimeve deri ne daten e rexhistritimit qe gjindet ne table .

Eshte ndoshta interesante te dime se Query-t kursejne edhe hapesiren ne diske. Nese per shembull eshte definuar nje fushe per neto qmimin dhe nje fushe per tatimin ne qarkullim, nuk ka nevojte te definohet fusha per qmimin bruto. Naturisht se qmimi bruto duhet te dihet , kete munde te llogaritni shume shpejte duke e rritur



Microsoft Access 97 per Windows

neto qmimin me vleren e tatimit. Ashtu qe nuk ka nevojë të definohet ndoj fushe extra.

Me me rendesi tek query-t munde të perdoren tek tabelat e relatuara dhe ato jo të relatuara.

Query-t munde të trajtoni edhe si filtra për pasqyrimin e të dhënave të duhura nga database.

Loojet e pasqyrimeve

Për deri sa të jeni duke punuar në Query ka mundësi të aktivizoni tri pasqya të ndryshme. Kalimi prej njërës paqyre në tjetrën arrihet duke klikuar në komandot e mënyse.

15.2.1. Design view

Në këtë pasqyre normalisht bëhet dizajnimi i query-t.

15.2.2. SQL-view

Në këtë pasqyre munde të dizajnoni query-n me ndihmën e SQL-instrukcioneve.

15.2.3. Datasheet view

Tregon rezultatin e query-t në formë të tabelës.

Rezultati munde të prezantohet edhe përmes komandos print preview.

15.3. Rexhistrimi i tabelleave dhe query-ve

Sikurse që e theksuam më herët në query nuk ruhen të dhënat. Access-i i prezanton rezultatet e query-ve në formën e quajtur dynaset e cila i ngjethet një tabelë, me disa dallime të vogla.

Gjate definimit të një query duhet të tregojmë atij se ku duhet të marrë të dhënat. Ato munde të jenë në tabelë mirpo edhe në dynaset. Në vazhdim në do të mirremi vetëm me tabelë. Tabelat munde të selektoni në dialog dritarën 'table view' e cila hapet pasi që të hyni në query dritarën, me kushte që më herët një ose disa tabelë kanë qenë të selektuara.


Kur të selektohet një tabelë kjo paraqitet në gjysmën e lartë të ekranit. Në titull qëndron emri i tabelës kurse në listë duken emrat e fushave të tabelës.

Nëse gjatë punës nuk keni nevojë për një tabelë të caktuar, kliko titullin e tabelës për të selektuar, dhe më pastaj asgjasoje atë duke shtypur komandon delete. Përndryshe rikthimi i tabelës në query arrihet përmes 'Query Show Table...'.

15.4. Ruajtja dhe ekzekutimi i query-ve

Gjate ruajtjes të një query, ruhet pra vetëm definimi i tij.

Mëny 'File → Save (As)' perdoret për ruajtjen e query-ve. Për ekzekutimin e një query, kliko në pike quditsen .

Një metodë e dytë për ekzekutimin e query-t është duke klikuar në komandon  dhe duke zgjedhur opcionin 'Datasheet view'.



Microsoft Access 97 per Windows

Emri i nje Query nuk munde te jete i njejte sikurse emri i tabelës . Tabelat dhe query-t permbajne te ashtuquajturin *recordset* ashtu qe mundemi qe te dyjat ti perdorim si baze per krijimin e formulareve dhe raporteve.



Microsoft Access 97 per Windows

16. DIZAJNIMI I NJE QUERY

16.1. Fushat

16.1.1. Shtimi i fuashave

Hapeni pasqyren design view te query dritares. Detyra e pare eshte te specifikojme se cilat fusha do te perfshihen ne query-n tone. Kjo arrihet ne metoda te ndryshme :

16.1.1.1. metoda e 1^{re} :

■ Ne pjesen e poshtme te query dritares gjindet query grid(ketu caktohen detyrat e query-t). Ne kete grid kliko ne kolonen e pare paralelisht me tekstin 'Field'(fusha), kur te tregohet nje shigjete e vogel kliko ne te dhe sikurse qe shifet tani paraqitet lista e fushave nga tabela / tabelat qe gjinden ne pjesen e nalte te ekranit ; kliko ne emrin e fushes se nevojshme nga tabela. Selektu edhe disa fusha tjera , perdore nje fushe per kolone , per te kaluar ne kolonen tjeter perdore komandon TAB ose kliko ne kolonen e duhur.

16.1.1.2. metoda e 2^{te} :

- Ne gjysmen e larte te dritares se dizajnit kliko fushen e duhur qe nevoitet per query , duke e mbajtur ctrl komandon e shtypur kliko ne disa fusha per te selektuar me shume se nje fushe nga tabela;
- Duke e mbajtur te shtypur komandon e djathte te mausit barti kolonat ne drejtimin e rasterit, kur te poziciononi mausin ne kolonen e zbrazet lirone komandon e mausit .

Ne raste kur deshironi qe ne query-n tone ti futni te gjitha fushat nga nje tabele , klikoni ne (*) qe gjindet ne listen e fushave ne brendesi te tabelës . Ky ylle eshte nje simbole qe nenkupton te gjitha fushat nga ajo tabele.

16.1.2. Eliminimi i fushave

Selektu fushen ne query grid dhe kliko ne pjesen e pehimte permby emrit te fushes dhe shtyp komandon delete . Eliminimi i te gjitha fushave arrihet permes meny 'Edit → Clear Grid'.

16.1.3. Bartja e fushave

Selektu fushen ne query grid duke klikuar ne vijen e perhimte horizontale permby emer kur kolona shendrrrohet ne ngjyre te zeze liro komandon e mausit , kliko prap ne te njejtin vende dhe duke e mbajtur te shtypur komandon e mausit barte fushen ne nje pozite tjeter.



Microsoft Access 97 per Windows

16.2. Sortimi

Ne access mundesh simbas deshires ti sortosh fushat. Klike ne nje kolone te caktuar ne query grid de me pastaj klike ne fushen 'Sort'. Ketu paraqitet lista e sortimit :
(prej 0 ne drejtim te 9, prej A ne drejtim te Z);
(prej 9 ne drejtim te 0, prej Z ne drejtim te A);

Kur deshiron te sortosh ne baze te disa fushave mbaje ne mende se Access-i ekzekuton sortimin ne baze te rradhitjes se fushave(ana e majte e fushave ka prioritet).

16.3. Mos pasqyrimi i fushave

Edhe pse disa fusha perdoren per sortimin e query-t , ka mundesi qe ato edhe pse e percaktojne rradhitjen e sortimi mos te tregohen ne dynaset .

Shembull : Don te prezentosh nje pasqyre te anetareve te personelit simbas moshes , mirepo datelindja nuk te intereson (nuk deshirone te jete e dukshme ne dynaset).

Kete e arrite duke klikuar ne katrorin 'Show' (aktivo ose deaktiv).

Klike ne pikequdites per te ekzekutuar query-n , dhe shif rezultatin.

16.4. Perpunimi i query-resultatit

Ne datasheet view shif rezultatin qe munde te perpunosh sikurse ne nje table te rendomte. Kjo do te thote se ke mundesi qe te rexhistrosh rekorde te reja , ti perirsosh ose ti asgjash ato. Rezultati i ketij perpunimi bartet automatikisht ne tabelen origjinale ! te cilen bile edhe mundesh te dergosh ne printer , te nderrosh fontet , formatin , lartesine si dhe gjeresine e kolonese . Me ne funde kur te behet ruajtja e nje query-t te gjitha keto elemente do te ruhen me te(pa te dhena).

16.5. Percaktimi i kriterit

Karakteristika me e rendesishme e query-t eshte mundesia e caktimit te kriterereve te ndryshme. Me termin kriterium nenkuptohet caktimi i kushteve per plotesimin e nevojës ne nivel te fushes ose tabelës.

Kete kriterium e percakton ne fushen gjegjese tek opcioni 'Criteria' ne query grid.

Operatorët e ardhshëm dhe joker karakteret munde te perdoren per caktimin e kriterereve :

Operator i	Domethenia	Shembull		
		Fusha	Sintaksa	Domethenia
=	i barabarte	shitesi	=Luli	I barabarte me Luli
>	Me e madhe se	Sasia_e_shitur	>5	Me e madhe se 5



Microsoft Access 97 per Windows

<	Me e vogel se	Data_e_shitjes	<#03-12-97#	Me e vogel 031297
>=	Me e madhe ose e barabarte me	Sasia_e_shitur	>=5	Me e madhe se 5 ose e barabarte me 5
<=	Me e vogel ose e barabarte me	Data_e_shitjes	<=#03-12-97#	Me e vogel se 03 12 97 Ose bararte me03 12 97
<>	Jo e barabarte me	lirimi	<>0	Jo e barabarte me 0
Between . .. End ...	Mes dy vlerash	Qmimi_i_blerjes	between 800 and 1000	Nje numer prej 800 E deri me 1000
In	Mes nje permbledhje vlerash	prodhuesi	In (JVC; SONY; AIWA)	Vetem prodhues JVC; SONY; AIWA. Duhet ndare me pikeprese
Is Null	Nje rekorde i zbrazet	Data_e_shitjes	Is Null	Fusha eshte e zbrazet
Is Not Null	Nje rekord jo i zbrazet	njejte	Is Not Null	Fusha nuk eshte e zbrazet
Like	Perdoret ne kombinim me jokera	Tipi	Like CD*	Tregohen te gjitha fushat qe fillojne me tekst CD
End	Te dy kushtet duhen te jene te verteta	Sasia_e_shitur	>=1 And <=3	mes 1 dhe 3 (shif larte)
Or	Njeri nga te dyte ose qe te dyte	shitesi	Luli Or Afrimi	Rekordet e te dy shitesve
Not	Jo e vertete	Sasia_e_shitur	Not 0	Vlerat e ndryshme nga 0 (<>0)

16.5.1. Joker karakteret

?	Qfaredo karakteri	Tipi	F?????	Te gjitha vlerat nga 6 karaktere qe fillojne me 'F'
*	Nje varg karakteresh	Prodhuesi	P*	Te gjitha vlerat qe fillojne me 'P'
#	Qfaredo	Tipi	Like "D #09"	# qfaredo numri



Microsoft Access 97 per Windows

	numri ne varg karakteresh			bas D dhe nje zbrazetire
--	------------------------------	--	--	--------------------------------

16.5.2. Referimi ne nje fushe tjeter

[emrifush es]	Nje fushe tjeter ne query grid	Qmimi_i_blerjes	>[qmimi_i_shitjes]	kontrole
------------------	--------------------------------------	-----------------	------------------------	----------

Ne access ka mundesi qe te caktohen disa kriterie nje kohesishte . Kjo kriterie munde te jete e bazuar ne nje fushe te njejte ose ne me shume fusha te ndryshme. Nese eshte rasti i disa kriterieve per nje fushe te njejte, eshte mire te perdoret operatori “OR”.

Shembull:

Per nje fushe qe quhet ‘Vendi’ ne nje query te paramenduar kliko ne criteria dhe shkruaj: “Prishtine” Or “Peje”.

Ne dynaset do te na tregohen te gjitha rekordet ku fusha vendi eshte e plotesuar me tekstin “Prishtine” ose “Peje”.

Ne rastet kur deshiron te formosh kriterie per disa fusha vepro si vijone :

- Te selektosh rekordet qe plotesojen te gjitha kriteriet e parashtruara , vendose kriterien ne fushen ‘Criteria’ ne rendin e njete;
- Te selektosh rekordet qe plotesojne njerin ose tjetrin kriteium, vendose ktiterien ne query grid neper rende te ndryshme.

shembull :

deshironi te shifni vetem ata persona qe i'u fillon emri me shkronjen “L” dhe qe jane te punesuar ne “Prishtine” . (=dhe operatori logjikee AND)

Field:	Vendi	Shitesi
Table:	Table1	Shitoret
Sort:		
Show:	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Criteria:	"Prishtine"	Like "L"

Te gjithë personat qe jane te punesuar ne “Prishtine” OSE ata persona qe i'u fillon emri me shkronjen “L” . (=dhe operatori logjike OR)



Microsoft Access 97 per Windows

Field:	Vendi	Shitesi
Table:	Table1	Shitoret
Sort:		
Show:	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Criteria:	"Prishtine"	
or:		Like "L:"

16.6. Dizajnimi i parameter query-t

Gjate dizajnit te nje selecti query percaktonim kushtet (criteria) te cilat duheshin te plotesohen, permes fushes 'Criteria' query grid.

Mirepo ekzistojene rastet kur done qe te caktoshe kriteriumin me vone, ose gjate punes se query-t. Per shembull done nje pasqyre te personave qe jane te punesuar ne "Prishtine", e me vone te atyre qe jane te punesuar ne "Peje", "Gjakove" e keshtu me rradhe. Ne principe duhet qe per qdo kriter te formoshe query te ri me kriter tjetet. Kete problem te perseritjes te te njejtes pune munde te zgjidhsh permes te ashtuquajturit parameter query. Ky lloj query perdore parameter (variabel). Kur te ekzekutohet parameter query te paraqitet me pyetjen se cili eshte kriteriumi.

Krijmi i nje parametri behet si vijone :

- Ne fushen 'Criteria' shkruaje kriterin sikurse tek select query, mirepo ketu kriteri duhet te qendroje mes kllapave katrore , ashtu qe me vone ke mundesi te caktoshe kriterin prej jashte ;
- Ne momentin kur behet ekzekutimi i query-t ne ekrane paraqitet nje dritare me pyetje; mbasi qe je pergjegje, query e vazhdone punen e vete, ose nese ke parapare me shume kriterato paraqiten nje mbas nje ne ekran, dhe me ne funde tregohet rezultati .


16.6.1. Shembull :

Field:	Vendi
Table:	Table1
Sort:	
Show:	<input checked="" type="checkbox"/>
Criteria:	[Cila Shitore ?]

Gjate ekzekutimit te ketij query do te paraqitet pyetja e ardheshme :



Microsoft Access 97 per Windows



Mbasi te shkruash psh. *Prishtine* dhe te klikosh ne 'OK' query do te vazhdoje punen e vete dhe do te tregojte rezultatin ne ekrane.

16.7. Percaktimi i Query-parametrave

Me ndihmen e query-properties munde te percaktosh nje numer parametrash te cilet do te udhehehin query-n gjate punes se tije psh. karakteristikat e fushave si dhe per vete karakteristikat e listes me fusha (pjesa e larte e ekranit te dizajnit).

Per te percaktuar keto karakteristika kliko ne objekt e me pastaj kliko ne  :

Objektet

- Ne listen me fusha per tregimin e karakteristikave nga lista e fushave ;
- Ne nje fushe ne query grid per karakteristikat e fushes;
- Ne mbrapashtesen e perhimte per karakteristikat e query-t.

Pershkrimin e karakteristikave munde te gjeni ne help duke klikuar ne psh. fushe e mepastaj duke aktivuar komandon e ndihmes F1 per karakteristikat e fushave .

16.8. Karakteristikat e Query-t

- Description : ketu pershkruan punen qe do te kryej query;
- Output all fields : per ti treguar te gjitha fushat nga te gjitha tabelat;
- top-values : kufizimi i rendeve ne dynaset;
- unieque values : kur te selektosh nje pjese te tabelës(psh. vetem 'vendbanimin') dhe te ekzekutohet query , i njeiti shenim do te na paraqite disa here(psh Prishtina sepse disa punetore jetojne ne Prishtine) perpos ne raste kur eshte vetem nje i rexhistruar nga nje vendbanim i caktuar (psh. nga. fshati Lismire kemi vetem nje punetore).Ky rezultate eshte ne rregull sepse kriteri yne ka ndikuar qe te tregojte te gjitha vendbanimet qe jane te rexhistruara ne tabele . Mirepo ne rastet kur deshirojme te dime se prej qfare vendbaimesh kemi puntore ne sherbim , atehere eshte e tepert qe psh Prishtina te figuroje disa here , per ti pare te gjitha vendbanimet por vetem nje here atehere vendose ne karakteristiken unieque values vleren 'Yes';
- unique Records : Tek perdorimi korrekte i qelesave dhe relacioneve ne gjithmone do te kemi vlere unike ne tabelen tone. Ne rastet tjera, e sidomos tek query-t te perbera nga disa tabela, munde te ngjaje te kemi rekorde te dyfishta. Duke e vendosur karakteristiken 'unique records' ne vleren 'Yes' rekordet e dyfishta nuk do te tregohen .Mbaje ne mende se vetem njera prej ketyre dy karakteristikave



Microsoft Access 97 per Windows

munde te kete vlere 'Yes' dmth ose karakteristika unique Records ose karakteristika unieque values , por jo qe te dyjat;

■ keto 6 karakteristikat e ardheshme kane ndikim tek Access-i vetem ne pune me rrjete ose Windows Nt dhe nuk do te diskutohen ketu ;

■ Run Permissions

■ Source Database

■ Source connect string

■ Record Locks

■ Record Set Type

■ Dhe ODBC Time Out

■ filter dhe order by : Ketu mundesohet qe rekordet te filtrohen dhe te sortohen , mirepo me mire eshte qe kete te beni ne query grid.

Karakteristika me e rendesishme eshte 'unique values' duke u nisur prej faktit se ne jemi me teper te interesuar qe ti tregojme vetem ato rekorde qe kane vlere unike e jo edhe vlerat qe shfaqen me shume se nje here. Kjo karakteristike mbetet aktive nese nje here e keni selektuar dhe munde te nderrohet simbas nevojës.

16.9. Llogaritjet ne query

16.9.1. Fushat llogaritese

Ne query munde te defionhen eksta fusha, qe nuk kane prejardhjen nga ndonje tabele mirepo jane rezultat i nje llogaritje qe eshte ekzekutuar ne baze te nje fushe tjeter.

Done qe pershembull pamvaresishte qe per qdo rekorde te llogaritet zbritje e mallit. Ashtu qe qmimi_i_shitjes duhet zbritur per 10 %.

Per te llogaritur kete zbritje duhet te formohet nje query i ri . Ne kolonen e pare vendose 'qmimi_i_shitjes'. Ne kolonen e dyte tek fusha 'Field' shkruajme nje fushe te re qe do ta quajme qmimi_i_zbritur , pas saje dy pika (:) dhe me pastaj formulën. Emri i fushave ne te cilat ne bazohemi duhet te shkruhen mes kllapave katrore.

Dhe definitivisht formula jone duhet dukej keshtu :

Qmimi_i_zbritur : [qmimi_i_shitjes]-[qmimi_i_shitjes]*10/100

Operatoret qe munde te perdoren per fushat llogaritese jane :

Operatori	Domethenia	Shembull
+	mbledhje	Qmimi_i_rrumbullaksuar : [qmimi_i_shitjes] + 10
-	Dallim(zbritje)	fitimi : [qmimi_i_shitjes] - [qmimi_i_blerjes]
*	shumezim	Premi : [Sasia_e_shitur] * 100
/	pjestim	Test1 : [Sasia_e_shitur] / 2



Microsoft Access 97 per Windows

Operatori	Domethenia	Shembull
\	Integer pjestim	Test2 : [Sasia_e_shitur] \ 2
^	fuqizim	Test3 : [Sasia_e_shitur] ^ 2
Mod	Mbetja pjestimit	Test4 : [Sasia_e_shitur] Mod 2
&	Konkatenimi (bashkangjitja)	Aparati : [Prodhuesi] & " " & [Tipi]

Ne raste kur perdoren emrat e fushave te tabelës ose te query-t, duhet ato emra gjithmone ti vendosni mes kllapave katrore.

Vrejtje :

- Ju mundeni te perdorni edhe kombinimin e komandove Shift-F2 per te rritur formatin e fushes ku jeni duke e shkruajtur formulën;
- Dritaren munde te rritni edhe duke klikuar ne komandon e djathte te mausit e me pastaj te zgjidhni opcionin 'Zoom...';
Formatin e nje fushe llogaritese e ndryshoni ne menyre te njejte sikurse ato te tabelës;
- Per formimin e nje fushe llogaritese kliko ne komandon e djathte te mausit dhe me pastaj zgjidhe opcionin 'Build...'; kjo eshte e perdorshme per pasqyrimin e mundesive te ndryshme qe i ofron access-i, por me pake per formimin e fushave llogaritese.

Ushtrime :

- Formo nje fushe llogaritese 'Brutoqmimi' ku tregon qmimin shites se bashku me tatim. Perdore fushat 'Qmimi_i_shitjes' dhe 'Ttimi'. Ne kete raste munde te implementohen dy formula :
 - $Qmimi_i_shitjes + Qmimi_i_shitjes * tatimi / 100$
 - $Qmimi_i_shitjes * (1 + tatimi/100)$
- Formo nje fushe llogaritese 'Aparati' dhe ku jane te theksuara te dhenat 'grupi', 'prodhuesi' dhe 'tipi'. Shembull : *Kompjutere : Philips - Pentium III*.

16.9.2. Me shume llogaritje dhe/ose kritere : perdorimi i funksioneve

Nese krijone nje fushe llogaritese , munde te perdorni funksionet standarde. Pasqyrimin e plote te funksioneve e gjeni ne Help. Mirepo sa i perkete datave keto funksione meritojne me shume vemendjen :

- Day(<data>) Nxjerre nje dite nga data (nje numer prej 1 e deri me 31).
Shembull : **Day**(01-12-1997) rezultone : 1.
- Month(<data>) Nxjerre muajin nga nje date, (nje numer pre 1 e deri me 12).
shembull : **Month**(01-12-1997) rezultone : 12.



Microsoft Access 97 per Windows

Year(<data>)	Nxjerre nje vite nga nje date. shembull : Year (01-12-1997) rezultone : 1997.
Now()	Rezulton daten dhe oren aktuale te windows-it : Now() .
Date()	Rezulton daten aktuale te windows-it : Date() .
DatePartl(intervali;data)	Rezultone nje pjese te dates (dit, kvartali,...). keto i kemi permende edhe me heret d, dd, k, yy, etj... shembull : DatePart("q"; 21-03-1997) rezultone : 1.

Shembujt e perdorimit te funksioneve te datave gjate percaktimit te kriterieve :

Date()	Te dhenat sot
<=Date()	Te dhenat sot dhe te gjitha datave me heret
Between Date() and Date() - 30 < Date() - 10	Te dhenat e 30 diteve te fundit Te dhenat qe jane me te vjetra se 10 dite

Nje funksion speciale eshte DateAdd(). Meket funksion caktone hapesiren qe bazohet ne nje interval tjetër nga ai qe jane ditet e bazuara.

Ndarja mes argumenteve te ndryshme arrihet normalishte duke e perdorur simbolin e pike preses (;).

16.9.3. Sintaksa :

DateAdd(<intervaliKohore>;<sasia>;<data>)

IntervaliKohore	Cakton intervalin e kohes, duhet te vendoset mes thojezave. Vlerat e mundeshme jane yyyy (viti), q (kvartali), m (muaji), y (dita ne vite), d (dita), w (java), ww (java), u (oret), n (minutat) dhe s (sekondat).
Sasia	Eshte nje numer qe cakton sasine e intervaleve. Nje numer pozitive ia shtone intervalin dates, kurse ai negativ e zbret intervalin nga data
Data	Eshte data ne te cilen veprohet.

16.9.4. Shembull:

Kriteri : **Between DateAdd("m" ; -4 ; Date()) And Date()**.

Me kete komande arrijme qe ti tregojme te dhenat e 4 muajve te fundit. Nese psh jemi ne muajin prill atehere i shohim te dhenat prej fillimit te dhjetorit e deri me tani.



Microsoft Access 97 per Windows

16.9.5. Funkcionet tjera

Int(<numer>)	Tregon nje numer me decimale si numer te plote. Shembull : Int(123,85) si rezultate tregon 123 . Kujdese : ketu nuk behet rrumbullaksimi i numrave , por tregohen vetem shifrat para preses !
Left(<fusha>; n)	Tregon n karakteret e fushes duke duke filluar nga ana e majte. Shembull : Left ('Tirana' ; 3) rezultone <i>Tir</i> .
Right(<fusha>; n)	Tregon n karakteret e fushes duke filluar nga anaa e djathte. Shembull : Right ('Tirana' ; 4) rezultone <i>rana</i> .
Mid(<fusha>; fillimi ; n)	Tregon n karakteret qe gjinden ne pjesen e fushes , ku <i>fillimi</i> caktohet me numrin e pare kurse gjatesia qe e kerkojme caktohet me numrin e dyte . Shembull : Mid ('Sar <u>anda</u> ' ; 4 ; 3) rezultonet <i>and</i> .


16.10. Grupimet me ndihmen e query-ve

Ne praktike shpeshe here paraqitet nevoja qe te behet perpunimi ne nje grup te caktuar te rekordeve. Per shembull nuk na itereson pasqyrimi i te gjitha rekordeve te nje shitesi te caktuar por nje pasqyrim total i nje periode te caktuar. Eventualishte pasqyrimin e shitjes mesatare simbas datave te shitesit te caktuar. Per kete lloj te pasqyrimin duhet te perdoresh funksionet interne :

Funkcioni	Pershkrimi
Totals	rezultone totalet
Avg	rezultone mesataren
Min	rezultone vleren me te vogel
Max	rezultone vleren me te larte
Count	rezultone sasine e fushave jo te zbrazeta
StDev	rezultone deviimin standarde
Var	rezultone te ndryshueshmet
First	rezultone vleren e rekordit te pare
Last	rezultone vleren e rekordit te fundit

Kur te kerkosh informatat e perbashketa (grupuara) , atehere ne te vertete nuk do te keshe pasqyrim te rekordeve individuale.

Per te bere perpunimin e nje grupimi duhet te veprosh si vijone :

- Selektaje dhe vendosi fushat ne query grid;
- Kliko ne komandon e totalit ne meny (), atehere na paraqitet nje ekstra rende 'Group by' ne qdo fushe te grid-it;
- Nese fusha duhet te grupoje te dhenat atehere ne fushe duhet te qendroje 'Group by' ;
- Per fushat qe nuk duhet te grupojne te dhenat zgjidh funksionin e nevojshem nga lista e funksioneve (qe u pershkrua me larte).




Microsoft Access 97 per Windows

Rezultati i perpunimit do te shprendahet ne grupe te ndryshme (shif datasheet view).

Shembull.

Percakto per qdo shites sasinë e shitur te mallit per grup.

Ne kete raste duhet te veproni keshtu :

Fushat : vendi_i_shitores, shitesi , sasia_e_shitur, data_e_shitjes dhe grupi (grupi munde ti kete keto vlera mobile,teknike ,ushqimore...) barti ne grid kliko ne simbolin e sigmes () dhe nderro 'group by' ne fushen sasia_e_shitur me funksion **sum** dhe ekzekuto query-n.

16.10.1. Perpunimi mbas selektimit te rekordeve te caktuara

Para se te behet perpunimi i te dhenave normalisht behet selektimi i rekordeve te caktuara. Ne raste kur fusha veq eshte e kyqur ne query sikurse ne shembullin e me larte atehere kriteriumin e fushes e cakton sikurse tek query-t e thjeshte. Mirepo nese duhet vendose kushtet ne ne nje fushe e cila nuk gjindet ne query dhe ne te cilen nuk duhet bere grupime atehere vendosim fushen ne grid , zgjzdhim funksionin 'Where' ne rendin **total** dhe cakton kriterin ne **criteria**.

Shembulli 1 : Kur fusha eshte prezente ne query.

Ne kete raste plotesone rendin **criteria** te fushes shitesi ku e shkruan emerin psh. 'Valdet' dhe me pastaj ekzekuton query-n.

Shembulli 2 : Kur fusha nuk eshte prezente ne query.

Te themi se doni te ekzekutoni query-n por se nuk jeni te interesuar ne njerën ane ne te dhenat e nje shitesi ose ne anën tjetër ne te dhenat e te gjithë shitesve mirepo vetem te atyre shitesve nga Prishtina. Per te aplikuar kete kriter duhet qe fushen 'vendi_i_shitores' te fusim ne query, te perdorim funksionin '**Where**' tek rendin **total** dhe ne **criteria** te shkruajme Prishtine.

16.10.2. Selektimi ne baze te perpunimit

Kur deshironi qe query te beje perpunimin e te dhenave dhe ne baze te ati rezultatit doni qe te beni selektimin e disa rekordeve te caktuara, atehere duhet te caktoni kriterin ne rendin **criteria** dhe te aplikoni funksionin nag rendi **totals** (sum, avg,...)

Shembull.

Deshirojme nje pasqyrim te shitjes mesatare per shites , mirepo vetem per ata shites tek te cilet sasia mesatare e shitur eshte me e madhe se 2 (> 2).

Selektojme fushat 'Shitesi' dhe 'sasia_e_shitur', tek fusha 'sasia_e_shitur' aplikojme funksionin 'Avg' dhe shkruajme ne **criteria** >2 .

16.10.3. Grupimi ne baze te nje pjese te dates

Ne praktike shpeshe here eshte e nevojshme qe ne baze te nje pjese te fushes Date/Time ti grupojme te dhenat. Ne kete menyre munde te prezentohen psh. toalet e javes ose te muajit. Per te arritur kete qellim bejme perdorimin e funksionit **Format**.



Microsoft Access 97 per Windows

Sintaksa :

```
Format([fusha];"pjesaedates")
```

Shembull.

Deshirojme te bejme nje paqyrim te artikujve te shitur simbas shitesit dhe simbas javes. Futi fushat 'Shitesi', 'Sasia_e_shitur' dhe 'data_e_shitjes' ne grid. Grupo simbas fushes 'Shitesi' , apliko 'Sum' ne fushen 'Sasia_e_shitur' dhe nderro 'data_e_shitjes' ne → Java_numer : **Format**([data_e_shitjes] ; "ww").

Ne menyre shume te ngjashme munde te perdorni edhe funksionet left, right dhe mid.



Microsoft Access 97 per Windows

17. ACTION QUERY

Action query është një query që na mundëson që një sasi të rekordeve të caktuara të cilat eventualisht plotësojnë një kriter të caktuar ti përpunojmë si një teresi të përbashkët. Kjo query mund të ndahet në 4 kategori të ndryshme. Qdo kategori ka për synim një punë specifike :

17.1.1. Make-Table-Query

Kjo kategori ka për detyrë që të gjitha rekordet që plotësojnë një kriter të caktuar të vendosen në një tabelë të re (mbaje në mend se rekordet origjinale mbeten në vendin e vetë kurse këtu vendosen vetëm kopjet e rekordeve që plotësojnë kriterin e caktuar).

17.1.2. Delete-Query

Kjo kategori ka për detyrë që të gjitha rekordet që plotësojnë një kriter të caktuar të asgjësojë ato mirëpo për dallim nga disa query-t tjera që veprojnë gjithëmonë me kopjet e shënimeve kjo i asgjëson direkt rekordet nga tabelën origjinale, dhe për këtë arsye duhet të keni kujdes gjatë përdorimit të tyre.

17.1.3. Append-Query

Kjo kategori ka për detyrë që të gjitha rekordet që plotësojnë një kriter të caktuar t'i shtojë në tabelë tjetër.

17.1.4. Update-query

Në praktikë kjo query kategori përdoret më së shpeshti. Kjo përdoret që një grup rekordesh të përpunojë me një veprim (një here).

Pasi që kjo kategori e action query -ve përpunon një grup të rekordeve me një veprim, ju këshillohet që : te ekzekutoni selection query normale me kriteriet e nevojshme, te kontrolloni rezultatin e nëse rezultati do të jetë i pranueshëm tek atëherë këtë e formoni si action query, dhe e ekzekutoni !!!.



Microsoft Access 97 per Windows

18. CROSSTAB QUERY

Ne rastet ku deshironi qe te dhenat ti gruponi ne baze te dy vlerave te ndryshme ne vende se ne baze te te nje vlere, perdoreni Cross Tab query-t. Shembull : deshirojme qe ti pasqyrojme te dhenat e grupuara ne baze te fushes 'tipi'. Dhe normalishte per fushen 'tipi' ne **total** caktojme 'group by' kurse per fushen 'sasia_e_shitur' caktojme **'sum'** . Nese deshironi qe te merrni edhe fushen 'vendi_i_shitores' edhe asaj ia shtoni opcionin 'group by' , pas ekzekutimi te ketij query ,rezultati do te jete i sakte , por sa i preketete formes ... , Shembull :

Vendi	i Grupi	Sasia e
PRISHTINE	AUTORADIO	31
PRISHTINE	CD-DISK	26
PRISHTINE	TELEVIZION	44
PRISHTINE	PORTABEL	22
PRISHTINE	TUNER	5
PRISHTINE	PERFORCUES	14
PEJE	AUTORADIO	21
PEJE	CD-DISK	24
etj...	etj...	etj...

Ndoshta me me qefe e kishim deshiruar kete forme:

Grupi	PRISHTINE	PEJE	GJAKOVE
AUTORADIO	31	21	14
CD-DISK	26	24	17
TELEVIZION	44	48	24
PORTABEL	22	18	8
TUNER	5	9	7
PERFORCUE	14	9	5

Ketu eshte fjala per CrossTab-Query(ose tabele e kryqezuar). Tek ky tip i tabelave duhet thekesuar se qka deshironi te tregohet ne rende dhe qka ne kolona(tituj). Per te prezentuar nje tabele te kryqezuar sikurse ne shembullin e me larte duhet te veprohet si vijone :

- Fillo nje query ne baze te nje tabele ekzistuese te improvizuar.
- Vendosi fushat 'Vendi_i_shitore', 'Grupi' dhe 'Sasia_e_shitur' ne query grid.
- Grupoje te dhenat , zgjidh 'group by' per dy fushat e para dhe zgjidhe 'sum' per 'Sasia_e_shitur'.
- Shiqoje se pari rezultatin ne select query dhe me vone transferoje keto ne CrossTab Query : dhe me ne funde aty na paraqitet nje rende ne query grid me titullin CrossTab .
- Deklaroje fushen 'vendi_i_shitores' si titull te kolones , kurse fushen 'grupi' si titull te rendeve dhe me pastaj deklaraje fushen 'sasia_e_shitur' si 'value' , sepse ketu deshironi qe ti shofish vlerat qe do te paraqiten ne ne table grid. Ky tip i tabelave munde te permbaje edhe disa tituj te rendeve (si per shembull fushat 'Prodhuesi' dhe 'tipe'), mirepo vetem nje fushe munde te definohet si titull i kolones dhe vetem nje fushe si 'value' .



Microsoft Access 97 per Windows



Microsoft Access 97 per Windows

19. FORMULARET

Me ndihmen e formulareve shenimet qe i kemi ne nje tabele ose qe i kemi nje nje qury rezultate ka mundesi qe ti prezentojme ne forma tjera , ti permirsijme te dhenat , te rexhistrijme shenime te reja si dhe te bejme shtypjen e te dhenave ne shtypes. Gjate dizajnit te formulareve keni mundesi te zgjidheni njeran nga dy metodat e dizajnit : **1.** Qe dizajnin ta keni plotesishte nen kontrollin tuaj ,pra dizajnimi do te behet ne teresi manualishte dhe **2.** Dizajnimi i formularit me ndihmen e wizard-it i cili do t'ju udheheqe gjate proqesit te dizajnit te nje formulari . Nese percaktoheni per metoden e dyte, pasi qe e keni perfunduar dizajnimin e nje formulari do te keni mundesi qe ate te nderroni ne vendet qe eventualisht doni te beni ndryshime ne formen e formularit. Sikurse tek Query-t edhe tek formularet perbehen prej disa llojeve te formulareve.

19.1. Formularet me nje kolone

Formulari me nje kolone eshte nje lloje formulari qe i paraqet te dhenat nga nje rekorde ne menyre te pasqyruar ne ekrane .Te gjitha te dhenat nga nje rekorde tregohen ne ekrane ne sekuenca(njera nder tjetren) dhe bukur te pasqyruara .

- Nga database dritarja kliko ne opcionin (faqen) '**Forms**' (Formularet) dhe kliko me pastaje ne komandon **new**.
- Selektoto 'Form wizard' dhe nje tabele ose nje query ekzistuese nga opcionin i me poshtem **choose the table or query where the object's data comes from** me pastaj kliko ne **OK**.
- Selektoto te gjitha fushat duke klikur ne komandon '>>' dhe me pastaj kliko ne komandon '**Next**'.
- Tek dritarja *What layout would you like for your form ?* (qfare pamje deshiron te kete formulari ?) Le te qendroje zgjidhja ne opcionin '**Columnar**' dhe kliko ne '**Next**'.
- Zgjidhe nje lay-out te caktuar per formularin tone (per shembull '**evergreen**' duke klikur ne listen qe na eshte ofruar munde te shifni se qfare mundesishe na lejone formulari i caktuar) , dhe me ne funde kliko ne komandon '**Next**'.
- Ne dritaren *what title do you want for your form* Caktoja nje emer formularit, dhe kliko komandon '**Finish**'.
- Tani munde te shikoni , permirsoni etj... Per te asgjësuar nje rekord kliko ne meny '**Edit → Delete Record**'. Per te kerkuar nje rekorde te caktuar zgjedhe komandon e meny-se '**Edit → Find**'. Kurse per te rexhistruara nje rekorde te ri kliko ne simbolin e **shigjetes me ylle** ose zgjidhe opcionin permes meny '**Edit → Go to → New record**'.



Microsoft Access 97 per Windows

19.2. Formularet tabulare

Pame se me formularet me nje kolone munde te pasqyrohen te dhenat e vetem nje rekordi. Kurse nese deshirojme qe ne njeran ane te pasqyrojme te dhenat ne lay-out te bukur dhe ne anen tjeter deshirojme qe te kemi mundesi te bejme pasqyrimin e disa rekordeve ne te njeten kohe , zgjedhim formularet tabulare.

Krijimi i nje formulari tabulare eshte proqese i njejte sikurse gjet krijimit te atij me nje kolone, mirepo tek dritarja *What layout would you like for your form ?* selektoni **'Tabular'** ne vende se **'Columnar'** dhe kliko **'Next'** .

■ Zgjidhe nje lay-out te caktuar per formularin tone (per shembull **'evergreen'** duke klikur ne listen qe na eshte ofruar munde te shifni se qfare mundesishe na lejone formulari i caktuar) , dhe me ne funde kliko ne komandon **'Next'**.

■ Ne dritaren *what title do you want for your form* Caktoja nje emer formularit, dhe kliko komandon **'Finish'**.

■ Tani munde te shikoni , permirsoni etj... Per te asgjësuar nje rekord kliko ne meny **'Edit → Delete Record '**. Per te kerkuar nje rekorde te caktuar zgjedhe komandon e meny-se **'Edit → Find'**. Kurse per te rexhistruara nje rekorde te ri kliko ne simbolin e **yllit** ose zgjidhe opcionin permes meny **'Edit → Go to → New record'**.

19.3. Puna me formulare kryesore - dhe sub formulare

Ne rastet kur deshironi ti shikoni ne ekrane ne te njejtën kohe te dhenat e tabelave qe jane ne relacion (psh. dy tabela) perdorni formularet kryesore dhe sub formularet. Per shembull , deshirojme qe te pasqyrojme ne ekrane te dhenat e nje klienti(emri , mbiemri , adresa...) dhe te dhenat per te gjitha blerjet e tije.

19.4. Formularet e shpejte

Ekzistojne 3 lloje te formulareve te shpejte qe ju mundesojne prezentimin e te dhenave nga tabelat ose query-t ne menyre te thjeshte dhe te shpejte . Ne keto raste Access-i ndertone ne menyre automatike nje formulare pa nerhyrjen e shfrytezuesit . Kurse me vone ndoshta do te duhet te behen disa rregullime ne formen e tyre , mirepo kjo e shte gjithashtu ne raste ku perdoret edhe wizard-i.

19.5. Pasqyrimet e ndryshme

Kur te hapet nje formulare, atehere kete munde te shiqojme ne 4 pasqyrime (metoda) te ndryshme.Qdo pasqyrim ka funksionet e veta specifike. Kalimi prej nje funksioni ne tjetrin arrihet permes meny-se kryesore.

19.5.1. Form View

Ky pasqyrim ju mundesone qe ti shikoni te dhenat nga tabelat ose query-t e ndryshem si dhe kerkimin e rekordeve te caktuara ne to.



Microsoft Access 97 per Windows

19.5.2. DataSheet View

Ky pasqyrim mundesone prezentimin e te dhenave preciz sikurse ne tabele. Ky pasqyrim eshte i aplikuashem ne raste kur deshirojme ti tregojme te gjitha rekordet. Dallimi i ketij pasyrimi dhe tabele qendron aty se ketu i tregojme te gjitha rekordet mirepo tregohen vetem ato fusha qe i kemi percaktuar gjate dizajnit te formularit. Dhe se ne kete formulare munde te shtojme edhe komando te ndryshme (command button, option button,...) kurse ne tabele te dhenat tregohen ne forme klasike.

19.5.3. Design View

Nese deshirojme te bejme ndryshime ne formularet qe i kemi krijuar permes wizard-it , ateher e kyqim kete opcion ne pune. Ne kete pasqyrim ka mundesi qe elementet e formularit ti bartim , t'ju nderrojme vendin , t'i zvoglojme, t'i rrisim , te nderrojme ngjyrat , te vendosim elemente te rej a, ti asgjesojme elementet qe ekzistojne etj... .

19.5.4. Print Preview

Ky opcion munde te aktivizohet permes Form View ose DataSheet View, ku permes te cilit mundesohet shtypja e te dhenave ne leter .Para se te dergoni te dhenat ne leter , eshte ide e mire qe nje here te shofish shembullin e shtypur . Ne kete menyre shfektet e objekteve visualisht, psh . a jane te ndara faqet , si eshte renditja e kolonava , etj...



Microsoft Access 97 per Windows

20. DIZAJNIMI I NJE FORMULARI

Ne pasqyrimin e dizajnit ke munesi ti shikoshe dhe ti rregullosh formularet. Ketu do te hasesh ne seksione , komando dhe mjete ndihmese te ndryshme.

20.1. Seksionet e ndryshme

20.1.1. Form Header(Titulli i formularit)

Permbane informaten qe do te jete e dukshme ne ekrane.

20.1.2. Detail(Detaji)

Permaben nje element kontrolli qe pranon vleren nga nje table ose query .

20.1.3. Form Footer(Fundi i formularit)

Permaben informate qe eventualishte do te tregohet ne funde te ekranit. Shpeshehere ky seksion eshte i zbrazet.

20.1.4. Hight/Width (lartesi dhe gjeresia e seksionit)

Lartesia dhe gjeresia e qdo seksioni munde te percaktohet : duke klikuar me maus dhe bartur vijen ndarese te seksionit kur nderrohet forma e mausit prej shigjete te bardhe ne shenjen plus me shigjete larte dhe poshte.

20.2. Elementet e ndryshme kontrolluese

20.2.1. Elementet e mvarura kontrolluese

Keto elemente jane ne lidheshmeri me elemente te ndryshme nga nje table ose query dhe jane mjete permes te cilave munde te pershtaten te dhenat. Shpeshehere ne kete grupe perdoret LABEL e cila e jepe pershkrimin e nje fushe ne te cilen munde te nderrohet ose te shenohet nje e dhene e re.

20.2.2. Elementet e pamvarura kontrolluese

Keto jane elementet qe nuk jane ne nderlidheshmeri me tabela ose query; Mirepo perdoren per qellime estetike si psh. nje vize ka per detyre te beje ndonje ndarje logjike te informatave ne ekrane ,titujt japin pershkrimin e nje formulari , form footer tregon statusin momentale ne database

20.2.3. Elementet kontrolluese per llogaritje

Nje element kontrollues jo vetem qe munde te beje nderlidhjen ne nje fushe te tabelës ose query-t, mirepo mundet te beje nderlidhjen edhe me ndonje funksion te caktuar apo ekspresion (formule), ku nje fushe e caktuar perdoret per llogaritje te ndonje vlere. Kete munde te klasifikoni ose te krahasoni me fushat llogaritese ne kuadrin e nje query.



Microsoft Access 97 per Windows

20.3. Mjetet ndihmese


20.3.1. Ruler / Grid

Eshte nje opcion i cili ndihmone per te bere vendosjen e elementeve ne formulare ne menyre precize . Kete ocion e aktivoni permes meny View dhe zgjidhni ' Ruler' ose/dhe ' Grid'. Per te deaktivuar kete opcion zgjidheni prape te njejtin meny pra View dhe zgjidhni ' Ruler' ose/dhe ' Grid' .

20.3.2. Tools(Veglat)

Kyt funksion perbene Vegla te ndryshme per pune te cilat perdoren gjate krijimit te elementeve te ndryshme ne formulare . Ky funksion aktivohet permes meny 'View → Tools'.

20.3.3. Karakteristikat e formulareve

Per qdo elemente dhe qdo seksion ne kuader te nje formulari munde te percaktohen karakteristika te ndryshme. Kjo arrihet duke klikuar dy here ne element ose ne seksion . I njehti efekt arrihet edhe duke klikuar ne simbolin e karakteristikave  e pastaj duke klikuar ne elementin ose seksionin qe e deshirojme .



Microsoft Access 97 per Windows

21. VENDOSJA E ELEMENTEVE

21.1. Udhezime te pergjithshme

Hape nje formulare te ri ne pasqyren e dizajnit dhe cakto nje titull ne seksionin Header.

21.1.1. Elementet e pamvarura kontrolluese

- Kliko ne **Tools** elementin e duhur , per shembull nje **label**.
- Kliko ne dhe duke e mbajtur mkomandon e maustit te shtypur barte label-en ne poziten qe deshirone ne seksionin Detail .
- Varesishte prej elementit te zgjedhur nevoitet te percillen disa opcione.
- Elementi i vndosur ne formulare pranone automatikisht nje label me teksti si psh "TekstiX" of "FushaX".

Shkruaj nje tekst ne tekstfushe , psh. "FORMULARI IME".

21.1.2. Elementet e mvarura kontrolluese

Per te vendosur nje element te mvarur ne formulare , se pari duhet te hapet lista e fushave te tabelës/query-t permes menu 'View → Field List...'. ose zgjidhni direkt nga meny larte duke klikuar ne 'Field List' :

- Kliko ne fushen e deshiruar dhe barte ate ne vendin e duhur ne formulare;
- Elementit te bartur ne formulare i percaktohet automatikisht nje label me permbajtje te emrit te fushes.

21.1.3. Elementet kontrolluese per llogaritje

- Kliko ne meny-ne e veglave dhe zgjidhe elementin (**ab|**), barte elementin ne poziten qe duhet vendosur ne brendesine e formularit.
- Elementit te bartur i percaktohet automatikisht nje labele me emrin e fushes psh. "fushaX".
- Shtyp ne vendin e tekstit formulen ose ekspresionin , fillo me "=".

Shembull : "= [sasia_e_shitur]*100".

21.2. Fusha e teksit

Kjo fushe eshte nje elemente qe perdoret per fushat e tipit tekst, numerik, valute, date/kohe dhe numeruese.

21.3. OptionButton, CheckBox ,Toggle Button

Keto tri elemente kane rrole plotesishte te njejete , dhe vetem forma e tyre ndryshone. Keto perdoren vetem per fushat e tipit 'Yes/No'. Nese klikohet ne njerën prej ketyre komandove, Rezultone vlere "Yes" perndryshe rezultati eshte "No".

- Kliko ne nje OptioButton , ne menyne e veglave.



Microsoft Access 97 per Windows

- Me pastaj kliko ne fushen e tipit 'Yes/No' ne listen e fushave duke e mbajtur te shtypur komandon e mausit barte fushen ne formulare.

21.4. ComboBox dhe ListBox

Keto dy elemente jane te pershtatshme per rastet kur varen nga nje fushe me permbajtje alfanaumerike, dhe vlerat te cilat i percaktohen jane me heret te definuara (shembull shitesi, Sepse te gjitha shitesat jane me heret te definuar ne tabelen tone). **ComboBox** eshte me i pershtatshem per perdorim : Perveq qe perbene listen e cila munde te tregohet ajo mundesone qe edhe vete te shkruajme nje vlere ne te , qka nuk eshte e realizueshme te **Listbox** dhe e cila si te mete ka perdorimin e hapesires mjaftte te madhe ne formulare , e cila shpeshe here eshte shume e nevojshme per prezentimin e te dhenave .

Kur deshironi te perdorni njerein prej ketyre dy elementeve te mvarura , duhet te kujdeseni qe informatat e sakta te pasqyrohen ne to . Ne kete drejtim wizard ju ndihmone shume. Permes wizard ju paraqiten mundesite e zgjedhjeve te tabelave per pune : ose perndryshe mundeni vete te shkruani emrin e tabelës ose te query-t qe deshironi te perdoreni .

Shembull 'shkruarja e vlerave' :

- Vendose nje ComboBox ne formulare, e cila e starton Wizard-in automatikisht;
- Nderroje opcionin standarde te wizard-it **I want the Cobo Box to look up the values in a table or query** dhe kliko ne vende te saje ne opcionin **I will type the values that I want** dhe me pastaj klikon ne **Next**;
- Wizard-i ju mundesone te punoni me dy kolona, Kjo eshte sume e perorshme ku deshironi per shembull te punoni me nje kod dhe pershkrim. Percakto numrin e kolonave qe deshironi te punoni, shkruaj alternativat dhe rregulloje gjeresine e kolonave. Shkruaj psh '25%' ne kolonen 1 dhe 'artikull i vendit' ne kolonen e 2. Perserite kete me '35%' dhe 'artikull i importuar' ne rendin e 2^{te}.
- Cakto se cila vlere (ne cilen kolone) do te vendoset ne table.
- Percakto tekstin i cili do te duket ne formulare pranr ComboBox-it.

Gjate perdorimit te Wizard-it plotesohen opcionet dhe karakteristikat kryesore te ComboBox-it . ne raste kur deshironi qe me vone te beni ndryshime ne to , kliko ne propertis dhe me pastaj kliko ne ComboBox :

